




CHILD SEXUAL
ABUSE PREVENTION
AND EDUCATION

Përvojat e lundrimit online të fëmijëve 9 - 11 vjeç në Shqipëri





CHILD SEXUAL
ABUSE PREVENTION
AND EDUCATION

Përvojat e lundrimit online të fëmijëve 9 - 11 vjeç në Shqipëri

Autore

Prof. Asoc. Dr. Veronika Duci

Prof. Asoc. Dr. Izela Tahsini

FALENDERIME

Ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për ekipet e përkushtuara të mbledhësve të të dhënave: Inva Mustafaraj, Loranda Palluci, Jonida Arkaxhiu, Jonila Llabani, Fatma Muca, Silva Vllaka, Siljeta Bushataj, Esmeralda Kola, Adela Kraja, përpjekjet e të cilave ishin thelbësore për suksesin e këtij studimi.

Një falënderim i veçantë për stafin e Zyrës së Save the Children në Shqipëri: Refik Cela, Drejtor i Zbatimit të Programeve, Sabina Carcani, Menaxhere e Programit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Qeverisjen e të Drejtave të Fëmijëve, Edlira Shima, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Gjininë, Elidjana Metani, Oficere e Zbatimit të Programeve dhe Eni Kruja, Specialiste e MEAL, për mbështetjen dhe profesionalizmin e tyre të palëkundur gjatë gjithë këtij projekti.

Kontributet tuaja kanë qenë të paçmueshme dhe ne vlerësojmë thellësisht përkushtimin dhe punën tuaj të palodhur.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret ose kopjohet lirisht nga specialistët e fushës, por jo për qëllime fitimprurese, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave të përmendura më sipër si burim. Pikëpamjet e shprehura nga ekspertët në këtë publikim jo domosdoshmërisht pasqyrojnë ato të Save the Children.



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**

Financuar nga Bashkimi Evropian. Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose Komisionit Evropian. As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti financiar nuk mbajnë përgjegjësi për to.

SHKURTESAT

IA	– Inteligjenca Artificiale
KP	– Kodi Penal
KDPM	– Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KDF	– Konventa për të Drejtat e Fëmijës
ASF	– Abuzimi Seksual i Fëmijëve
MASF	– Materiale të Abuzimit Seksual të Fëmijëve
SHASF	– Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual i Fëmijëve
IoM	– Interneti i Mjeteve
PC	– Kompjuter Personal
VR	– Realiteti Virtual

Lista e tabelave	Faqe
Tabela 1, Mosha, gjinia dhe shpërndarja gjeografike e kampionit	17

Lista e grafikëve	Faqe
Grafiku 1. Shpeshtësia e përdorimit të internetit	18
Grafiku 2. Pronësia dhe aksesit në pajisjet personale për përdorim të internetit	18
Grafiku 3. Sa orë në ditë kaloni në internet për aktivitetet e mëposhtme?	19
Grafiku 4: Përfshirja e prindërve në përvojat e fëmijëve në internet.	20
Grafiku 5. A flet me prindërit tuaj (ose kujdestarët) për gjërat që bëni në internet ose në rrjetet sociale?	20
Grafiku 6. Sa shpesh ke bërë një nga këto gjëra në internet ose në telefon vitin e shkuar?	21
Grafiku 7. Sa shpesh ke komunikuar me këta njerëz duke hyrë në internet ose me anë të një aplikacioni me mesazhe të shpejta (Snapchat, Whatsapp, Viber, etj.)?	22
Grafiku 8. Llogari personale	24
Grafiku 9. Cilat nga këto informacione rreth teje shfaqen në llogarinë tënde?	25
Grafiku 10. Si u përgjigjesh zakonisht kërkesave për shoqëri nga njerëzit në internet (kërkesave për miqësi)?	26
Grafiku 11. A ke parë ndonjë nga të mëposhtmet në internet?	27
Grafiku 12. Besimi se në internet ka gjëra shqetësuese ose të mërzitshme në internet	27
Grafiku 13. Sa shpesh ka ndodhur diçka në internet ose në telefon që të ka mërzhitur apo shqetësuar në njëfarë mënyre (vitin e shkuar)?	28
Grafiku 14. Herën e fundit që ndodhi diçka në internet ose në telefon që të mërzhiti apo të shqetësoi në njëfarë mënyre, a bërë ndonjë nga këto veprime më pas?	29
Grafiku 15. Takim ballë për ballë me një person të kontaktuar vetëm përmes internetit	30
Grafiku 16. Mosha e personit të takuar ballë për ballë	30
Grafiku 17. Kujt i tregove (nëse i tregove dikujt) se ku do të shkoje? (n=101)	30
Grafiku 18. Ekspozimi ndaj fotografive, videove ose shkrimeve të papërshtatshme	31
Grafiku 19. Cilën nga këto gjëra ke parë (nëse ke parë) në internet ose në telefon vitin e shkuar?	31
Grafiku 20. A ke parë faqe interneti ose diskutime në internet ku njerëzit tregojnë një nga këto gjëra ose flasin për to?	32
Grafiku 21. A të ka ndodhur ndonjë nga gjërat e mëposhtme në internet (vitin e shkuar)?	32
Grafiku 22. A ke përjetuar ndonjëherë prej këtyre gjërave në internet ose në telefon (vitin e shkuar)?	33
Grafiku 23. A ke folur me ndonjë prej këtyre njerëzve për këtë gjë?	33
Grafiku 24. Herën e fundit që ndodhi diçka në internet ose në telefon që të mërzhiti apo të shqetësoi në njëfarë mënyre, a bërë ndonjë nga këto veprime më pas?	34

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bota digjitale është bërë pjesë integrale e jetës së fëmijëve, duke ofruar mundësi për edukim dhe ndërveprim social, por edhe duke i ekspozuar ndaj rreziqeve të konsiderueshme. Ky raport fokusohet në përvojat në internet të fëmijëve 9-11 vjeç në Shqipëri, duke synuar të kuptojë sjelljet, rreziqet dhe ndërgjegjësimin e tyre për mekanizmat e raportimit për rreziqet online. Studimi kontribuon në përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar mjedise më të sigurta në internet dhe për të rritur edukimin digjital të fëmijët.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KËRKIMIT

Studimi synon të eksplorojë sjelljet online të fëmijëve të moshës 9-11 vjeç, duke u fokusuar në:

1. Identifikimin e qëndrimeve dhe praktikave të fëmijëve të moshës 9-11 vjeç në lidhje me aktivitetin online.
2. Vlerësimin e aftësisë së fëmijëve të kësaj moshe për të njohur situata potencialisht të rrezikshme.
3. Vlerësimin e ndërgjegjësimin të fëmijëve të moshës 9-11 vjeç për raportimin dhe mekanizmat mbështetës në rast abuzimi online.

METODOLOGJIA

Studimi përdori një qasje sasiore, duke anketuar 1,085 fëmijë të moshës 9-11 vjeç nga zonat urbane dhe rurale në Shqipëri. Një pyetësor i strukturuar, i përshtatur nga metodologjia Global Kids Online, u administrua në internet. Të dhënat u analizuan duke përdorur statistika përshkruese dhe tabela të kryqëzuara. Konsideratat etike përfshinin pëlqimin prindëror, pëlqimin e fëmijëve dhe protokollet mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e pjesëmarrësve.

GJETJET KRYESORE

1. Sjelljet në internet :

- Shpeshtësia e përdorimit: 57% e fëmijëve përdorin internetin çdo ditë, me angazhim të konsiderueshëm në mediat sociale, lojëra dhe aktivitete edukative.
- Zotërimi i pajisjes: 40% e fëmijëve hyjnë në internet përmes pajisjeve personale, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të pambikëqyrura.
- Dallimet gjinore dhe moshore: Djemtë angazhohen më shumë në lojëra, ndërsa vajzat fokusohen në aktivitete edukative. Fëmijët më të rritur tregojnë angazhim të shtuar në rrjetet sociale.

2. Ndërgjegjësimi dhe rreziqet :

- Sjelljet e rrezikshme: 8% e fëmijëve pranojnë të gjitha kërkesat për miqësi dhe 24% shënojnë një moshë tjetër në internet, duke paraqitur shqetësime për privatësinë dhe sigurinë.
- Ekspozimi në përmbajtje të dëmshme: 39% raportojnë se kanë hasur përmbajtje shqetësuese, duke përfshirë mesazhe urrejtjeje, imazhe dhe materiale të dëmshme.
- Ndërgjegjësimi për mjetet e sigurisë: Gati gjysma e fëmijëve nuk janë në dijeni të mjeteve të sigurisë në internet si funksionet e bllokimit ose raportimit.

3. Përgjigjet ndaj çështjeve shqetësuese në internet :

- Mekanizmat e përballimit : Shumë fëmijë adoptojnë qasje pasive (p.sh., injorimi i çështjes). Masat proaktive si bllokimi ose raportimi janë më pak të zakonshme.
- Ndikimi emocional: 41% e fëmijëve ndihen fajtorë pasi hasin në përmbajtje shqetësuese, e cila mund t'i dekurajojë ata të kërkojnë ndihmë.
- Rrjetet mbështetëse: Fëmijët mbështeten shumë të bashkëmoshatarët për mbështetje, me komunikim të kufizuar me të rriturit e besuar.

REKOMANDIMET KRYESORE

1. Të orientuara ndaj fëmijëve:

- Zbatoni programe të edukimit digjital duke u fokusuar në sjelljet e sigurta në internet dhe përdorimin efektiv të mjeteve të sigurisë.
- Rritni ndërgjegjësimin për mekanizmat e raportimit dhe inkurajoni komunikimin me të rriturit e besuar.

2. Të orientuara nga prindërit :

- Zhvilloni programe trajnimi për të përmirësuar aftësitë e prindërimit digjital, veçanërisht në zonat rurale.
- Nxitni komunikimin e hapur me fëmijët rreth aktiviteteve në internet, duke përfshirë tema të ndjeshme si ngacmimi dhe privatësia.

3. Të orientuara nga shkollat :

- Trajnoni mësuesit/et dhe stafin psikosocial për të adresuar sigurinë në internet dhe për të mbështetur fëmijët në menaxhimin e rreziqeve digjitale.
- Promovoni programe të mbështetjes së kolegëve për të inkurajuar praktika të sigurta në internet brenda komunitetit të shkollës.

Ky studim nxjerr në pah nevojën kritike për përpjekje të koordinuara nga politikëbërësit, edukatorët dhe prindërit për të mbrojtur fëmijët në epokën dixhitale. Ndërhyrjet e përshtatura që adresojnë dallimet specifike të moshës, gjinisë dhe rajonit do të jenë instrumentale për të siguruar një mjedis më të sigurt në internet për fëmijët në Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	8
1.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit	9
1.2. Pyetjet kërkimore	9
1.3. Përmbledhje e studimeve dhe raporteve kombëtare më të fundit lidhur me temën e studimit.....	10
1.4. Përmbledhje e kuadrit ligjor dhe të politikave	11
2. METODOLOGJIA	14
2.1. Hartimi i studimit	14
2.2. Kampionimi	14
2.3. Instrumenti i kërkimit	14
2.4. Analiza e të dhënave	15
2.5. Konsideratat etike	15
2.6. Risqet dhe kufizimet	16
3. GJETJET	17
3.1. Koha e shpenzuar përpara ekranit në internet dhe sjelljet e rrezikshme	17
3.2. Komunikimi në internet	22
3.3. Dëmet në internet	27
3.4. Risqet në internet	29
4. PËRFUNDIME	35
4.1. Sjelljet e fëmijëve në internet	35
4.2. Ndërgjegjësimi i fëmijëve për situatat e rrezikshme në internet	36
4.3. Përgjigjet e fëmijëve ndaj situatave të rrezikshme dhe ndërgjegjësimi për mekanizmat e raportimit	36
5. REKOMANDIMET	38
5.1. Ndërhyrje të orientuara drejt fëmijëve	38
5.2. Ndërhyrje të orientuara drejt prindërve	38
5.3. Ndërhyrje të orientuara drejt shkollave	39
6. REFERENCAT	40

1. HYRJE

Tashmë, interneti i ka transformuar jetët tona me një ritëm dhe shkallë të paprecedent. Për një pjesë të madhe fëmijësh në vendet në zhvillim, bota digjitale është bota që ata njohin dhe në të cilën jetojnë çdo ditë. Ata po shndërrohen në brezin e përgatitur për revolucionin e katërt industrial dhe të 5G-së, ku Interneti i Mjeteve (IoM), robotika, realiteti virtual (RV) dhe inteligjenca artificiale (IA) po ndryshojnë mënyrën në të cilën ne jetojmë dhe punojmë.¹

Fëmijët hasen me një sërë rreziqesh dhe kërcënimesh në internet, duke filluar nga shërbimet e zhvilluara dobët, që i përballin (qëllimisht ose jo) me kontakte të papërshtatshme për moshën, te bullizmi kibernetik dhe ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, e deri te ngacmimi i rëndë, ndjellja (*grooming*) në internet, radikalizimi, si dhe shfrytëzimi dhe abuzimi seksual. Është përgjegjësia e të rriturve që të gjejnë mënyra për zbutjen dhe parandalimin e këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve.²

Në vitin 2022, më shumë se një e treta e të rinjve në 30 vende raportuan se ishin bullizuar në internet, ku 1 në 5 kishin munguar edhe në shkollë për këtë arsye. Rreth 80% e fëmijëve në 25 vende raportuan se ndiheshin të rrezikuar nga abuzimi ose shfrytëzimi seksual në internet.³

Gjithashtu, INHOPE raportoi se shpeshtësia e fëmijëve në moshë para pubertetit (3-13 vjeç) të paraqitur në pamjet dhe videot e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual të Fëmijëve (SHASF) u rrit nga 56% i të gjitha materialeve të paligjshme (122,276) në vitin 2016, në 79% (148,041) në vitin 2017 dhe 89% (223,999) në vitin 2018. Në vitin 2023, u shënua një rritje prej 5% e numrit të viktimave në moshë pubertetit (14-17 vjeç) të paraqitura në materialet e abuzimit seksual të fëmijëve (MASF) të raportuara dhe përpunuara, nga 11% në vitin 2022 në 16% në vitin 2023. Megjithatë, pavarësisht se organizata përmend disa ndryshime të lehta, shumica e viktimave të MASF-së vijnë të jenë fëmijë të moshës para pubertetit (3-13 vjeç). Sikurse në vitet e mëparshme, edhe të dhënat për vitin 2023 tregojnë se rreth 95% e viktimave në këto materiale janë femra. Krahas kësaj, shihet një reduktim në numrin e viktimave meshkuj, me një rënie nga 7% në vitin 2022 në rreth 3% në vitin 2023.⁴

Në përputhje me sa më sipër, sipas një ankete nga Instituti i DQ-së në vitin 2020, që mbuloi 63% të popullsisë botërore, *6 nga 10 fëmijë të moshës 8-12 vjeç janë të ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh kibernetike në internet*. Krahas kësaj, 1 në 2 fëmijë përballen me bullizëm kibernetik dhe thuhet një e treta hasin kërcënime të tjera kibernetike, si *phishing* dhe hakerimi.⁵

1 Komisioni Broadband për Zhvillim të Qëndrueshëm (2019). Child Online Safety: Minimizing the Risk of Violence, Abuse and Exploitation Online [Siguria e fëmijëve në internet: Minimizimi i rrezikut të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit në internet]. Tetor 2019. I disponueshëm në adresën https://www.broadbandcommission.org/Documents/working-groups/ChildOnline-Safety_Report.pdf

2 Po aty

3 UNICEF (23 qershor 2022). Protecting children online [Mbrotja e fëmijëve në internet]. I disponueshëm në adresën <https://www.unicef.org/protection/violence-against-children-online>

4 INHOPE (2023). Raporti vjetor për vitin 2023. I disponueshëm në adresën <https://inhope.org/media/pages/articles/annual-reports/6a4f5f6bd2-1710410986/inhope-annual-report-2023.pdf>

5 Instituti i DQ-së (2023). Global Standards for Digital Development [Standardet Globale për Zhvillimin Digjital]. I disponueshëm në adresën <https://www.dqinstitute.org/>

Në këtë kontekst, Save the Children zhvilloi projektin CSAPE (Edukimi dhe Parandalimi i Abuzimit Seksual të Fëmijëve), 2022-2024, që ka si objektiv përmirësimin e parandalimit të abuzimit seksual të fëmijëve (ASF). Për të forcuar ndikimin e Projektit, u krijua një konsorcium për të përfshirë vendet e BE-së dhe ato evropiane (Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Islandë, Greqi dhe Finlandë). Duke pasur si objektiv forcimin e përpjekjeve të anëtarëve të CSAPE-s për advokaci dhe komunikim për parandalimin dhe mbrojtjen e abuzimit seksual të fëmijëve në internet, nëpërmjet zhvillimit të të dhënave të përditësuara për temën, Projekti CSAPE planifikoi të zhvillonte një anketë në internet për qëndrimet dhe praktikatat e fëmijëve lidhur me sjelljen e tyre në internet, aftësinë për të njohur situatat e mundshme të rrezikshme në internet, dhe informimin për mekanizmat e disponueshëm të raportimit dhe mbështetjes në rast abuzimi në internet në vendet e tyre përkatëse. Anketa ishte e nevojshme duke qenë se të dhënat e disponueshme ishin tashmë të vjetruara. Anketa u udhëhoq nga Save the Children Shqipëri dhe u zbatua nga tre vende pjesëmarrëse (Bosnjë-Hercegovinë, Shqipëri dhe Greqi). Rezultatet e saj do të përdoren në nivel kombëtar për të mbështetur përpjekjet për advokaci dhe komunikim.

1.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të eksplorojë qëndrimet dhe praktikatat e sjelljes së fëmijëve të moshës 9-11 vjeç në internet, duke u fokusuar te rreziqet dhe kërcënimet që hasin dhe dijeninë e tyre lidhur me mekanizmat e raportimit.

Objektivat specifikë janë sa më poshtë:

1. Të identifikohen qëndrimet dhe praktikatat e fëmijëve të moshës 9-11 vjeç sa i përket sjelljes së tyre në internet
2. Të vlerësohet aftësia e fëmijëve të moshës 9-11 vjeç për të njohur situatat potencialisht të rrezikshme në internet
3. Të vlerësohet dijenia e fëmijëve për mekanizmat e disponueshëm të raportimit dhe mbështetjes në rastin e abuzimit në internet.

1.2. PYETJET KËRKIMORE

Duke u mbështetur te synimi dhe objektivat e anketës, pyetjet kërkimore për këtë studim janë:

- Cilat janë qëndrimet dhe praktikatat e fëmijëve të moshës 9-11 vjeç sa i përket sjelljes së tyre në internet?
- Në çfarë mase janë fëmijët e moshës 9-11 vjeç të aftë të njohin situatat potencialisht të rrezikshme në internet?
- Si reagojnë fëmijët në rastet e abuzimit të mundshëm në internet? A kanë ata njohuri rreth mekanizmave të disponueshëm të raportimit dhe mbështetjes?

1.3. PËRMBLEDHJE E STUDIMEVE DHE RAPORTEVE KOMBËTARE MË TË FUNDIT LIDHUR ME TEMËN E STUDIMIT

Kërkimet për përvojat e fëmijëve në internet në Shqipëri janë shumë të pakta. Mundëm të gjejmë vetëm një studim të vjetër të vitit 2014, i cili na jep një pamje të hershme të mjedisit në internet, por që përqendrohet te të rinjtë nga 13 deri në 18 vjeç, ndërsa fëmijët 9-11 vjeç nuk janë përfshirë (World Vision, 2014)⁶. Aksesit në internet ishte i lartë, me 85% të të rinjve të anketuar që kishin kompjuter në shtëpi (62% e këtyre pajisjeve ndodheshin në dhomat e tyre), ndërkohë që në atë kohë edhe internet-kafetë ishin shumë të aksesueshme. Pajisjet më të përhapura për aksesin në internet ishin celularët (65%), PC-të (kompjuterat personalë) (69%), dhe laptopët (43%). Nga të anketuarit, 44 për qind pohonin se e përdornin internetin për të parë çdo ditë materiale pornografike, ndërsa 62 për qind konfirmonin se kishin shokë që vizitonin faqe interneti të ngjashme. Bullizmi, vjedhja e fjalëkalimit dhe shikimi i paqëllimshëm i pornografisë u ndodhte çdo ditë 45 për qind të të anketuarve. Po ashtu, 47 për qind e të anketuarve të rinj ishin kontaktuar në internet një i panjohur në vitin e shkuar, i cili, në 2 nga 40 për qind të rasteve, ishte i huaj. Përqindjet e rrezikut brenda grupmoshës 13-18 vjeç ishin shkak për shqetësime serioze dhe ndërthureshin me përqindjet e ulëta të ndarjes së informacionit për sigurinë në internet. Vetëm 44 për qind e fëmijëve merrnin informacion mbi sigurinë në internet nga prindërit ose nga kanale të ndryshme raportuese mbi aksidentet online, gjë që tregon për një hendek të konsiderueshëm ndërmjet brezave. Fëmijët i shihnit prindërit (48%), shokët (37%) dhe motrat e vëllezërit (36%) si personat e parë për të raportuar një problem, ndërsa mësuesit (32%) dhe policia (27%) shiheshin si më pak të mundshmet për të raportuar (World Vision, 2014)⁷.

Studimi i dytë dhe i fundit kombëtar për përvojat në internet të fëmijëve (9-17 vjeç) u publikua në vitin 2019, duke përdorur një kampion përfaqësues kombëtar dhe ofroi një panoramë të qartë për jetën e fëmijëve shqiptarë në internet. Të dhënat tregojnë se fëmijët shqiptarë fillojnë ta përdorin internetin rreth moshës 9.3 vjeç, ndërsa brezi i ri i vajzave dhe djemve kanë më shumë gjasa ta përdorin më herët, përkatësisht në moshën 8 vjeç ose më pak. 35% e fëmijëve 9-11 vjeç mund të hynin në internet sa herë që duan, ndërkohë që kufizimi prindëror ishte arsyeja më e zakonshme për mungesën e aksesit, sidomos në këtë grupmoshë. Rreth 70.4 për qind e prindërve të intervistuar ishin përdorues interneti, ndërsa gati 30 për qind nuk e përdorin kurrë internetin. Aktivitetet më të zakonshme që fëmijët 9-11 vjeç praktikojnë çdo javë ose më shpesh ishin shikimi i videoklipeve (88%), përdorimi i tij për detyra shkolle (68%) dhe shikimi i shfaqjeve televizive/filmave (64%), ndërsa më pak të zakonshme ishin aktivitetet qytetare si përfshirja në bamirësi/organizata vendore (3%), përfshirja në fushata/protesta (2%) dhe nënshkrimi i peticioneve në internet (1%). Aftësitë digjitale më të zhvilluara të fëmijëve i përkisnin fushës së aftësive operacionale dhe marrëdhënieve sociale, ndryshe nga aftësitë krijuese që ishin më pak të zhvilluara. Me kalimin e kohës, fëmijët angazhohen në një gamë më të gjerë aktiviteteve dhe besojnë më fort në aftësitë e tyre digjitale. Fëmijët nën 10 vjeç kishin më pak besim tek aftësitë që lidhen me sjelljet sociale në internet. Ekzistonte një hendek gjinor i qëndrueshëm për sa iu përket aktiviteteve në internet dhe aftësive digjitale, pasi djemtë kryenin më shumë aktivitete në internet dhe kishin aftësi digjitale më të mira sesa vajzat. YouTube dhe Instagram ishin rrjetet ose aplikacionet më të përdorura nga fëmijët, ndjekur nga Facebook dhe WhatsApp (Dunja et al, 2019).⁸

6 World Vision. 2014. Studim mbi Sigurinë e Fëmijëve në Internet në Shqipëri. I disponueshëm në: <https://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>

7 Po aty.

8 Dunja A, Gjergji O, Gvineria D, Hallkaj E, dhe Verzivoli I. 2019 One Click Away: Children's Experience of Internet Use in Albania. [Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri]. UNICEF në Shqipëri & IPSOS Strategic Marketing, Tiranë. I disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/media/4346/file/One%20Click.pdf>

Për sa u përket rreziqeve në internet, studimi tregoi se 10% e fëmijëve 9-11 vjeç kishin përvoja të pakëndshme në internet gjatë vitit të shkuar Kur iu ndodhte diçka e pakëndshme në internet, fëmijët e të gjitha grupmoshave parapëlqenin të mbështeten nga bashkëmoshatarët e tyre dhe ngurronin të flasin me mësuesit ose profesionistët e kujdesit ndaj fëmijës. Rreziku më i zakonit përmbajtësor që u kanosej fëmijëve shqiptarë ishte ekspozimi ndaj dhunës së vërtetë, duke prekur më shumë se 22% të fëmijëve 9-11 vjeç në vitin e shkuar. Përgjithësisht, fëmijët ekspozoheshin ndaj përmbajtjes seksuale në internet në mënyrë të pavullnetshme, nëpërmjet dritareve me reklama. Në të njëjtën kohë, më shumë se gjysma e fëmijëve raportonin se kishin parë përmbajtje seksuale në internet me dëshirën e tyre. Vetëm një përqindje e ulët, kryesisht fëmijë në moshë të vogël ishin ndjerë keq pasi kishin parë përmbajtje seksuale, ndërsa shumica ishin ose indiferentë ose të kënaqur. 9% e fëmijëve 9-11 vjeç raportonin se kishin pasur të paktën një herë kontakt në internet me dikë që nuk e kishin takuar kurrë ballë për ballë dhe 7% e fëmijëve raportibub se kanë takuar personalisht dikë me të cilin kanë pasur kontakt vetëm në internet. Vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve ishin ndjerë keq nga këto takime ballë për ballë. 7% e fëmijëve 9-11 vjeç raportonin se kishin qenë të ekspozuar ndaj përmbajtjeve seksuale gjatë vitit të shkuar, edhe pse të dhënat nga studimi i World Vision jepnin shifra shumë më të larta. Ndoshta kjo lidhet me metodën e anketës në familje të përdorur në studimin e UNICEF-it. 5% e fëmijëve 9-11 vjeç raportuan të paktën një përvojë seksuale të padëshiruar në internet gjatë vitit të shkuar. Prindërit e raportoonin ekspozimin e fëmijëve të tyre ndaj rreziqeve në internet shumë më pak sesa vetë fëmijët, çka tregon një mungesë të mundshme komunikimi dhe besimi midis tyre, (Dunja et al, 2019).⁹

Të dhënat më të fundit për sigurinë në internet janë gjeneruar nga Linja Kombëtare e Ndhmës për Sigurinë e Fëmijëve në Internet në Shqipëri, iSIGURT.al., bazuar në informacionin e dhënë nga fëmijët, prindërit, mësuesit, kujdestarët, etj., që raportojnë në linjën e ndihmës. Raporti i fundit vjetor Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, i vitit 2023, tregon se kishte 244 raportime për incidente të hasuara dhe të raportuara në internet nga fëmijët, prindërit, mësuesit, kujdestarët, etj., gjatë vitit 2023, që në krahasim me vitin e shkuar, tregoi 160 për qind rritje në incidentet e raportuara në internet. Krahasuar me vitet e mëparshme, bullizmi në internet në vitin 2023 është incidenti në internet më i raportuar nga fëmijët në Shqipëri. Për herë të parë, vajzat raportojnë dy herë më shumë incidente në internet krahasuar me djemtë. Grupmosha e atyre që raportojnë vazhdon të kryesohet nga adoleshentët e moshës 15-18 vjeç, ndjekur nga ata të moshës 18-30 vjeç dhe 11-14 vjeç. Për herë të parë, u raportuan incidente nga fëmijët dhe për fëmijët nën moshën 11 vjeç (katër raste).¹⁰

1.4. PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR DHE TË POLITIKAVE

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, kuadri ligjor për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme, me hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e fëmijëve ndaj dhunës, shfrytëzimit dhe neglizhimit, përfshirë edhe mbrojtjen ndaj dhunës seksuale. Legjislacioni shqiptar ka shumë në fokus çështjet e dhunës dhe abuzimit seksual, dhe ngacmimit seksual. Këto çështje trajtohen nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore. Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat e rëndësishme ndërkombëtare lidhur me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe është palë e dokumentave ndërkombëtarë dhe rajonalë shtesë. Një hap i rëndësishëm në këtë aspekt është ratifikimi i Konventës së Lanzarotës me anë të Ligjit Nr. 10071, datë 9.2.2009, një proces që i kërkon Shqipërisë ta përafrojë kuadrin e saj ligjor me dispozitat e Konventës.

⁹ Po aty.

¹⁰ <https://www.crca.al/en/albanian-authorities-unprepared-to-protect-children-in-cyberspace/>

Shqipëria ka miratuar dhe ndryshuar gradualisht legjislacionin kombëtar lidhur me shfrytëzimin seksual të fëmijëve për t'u përafuar me angazhimet e saj ndërkombëtare dhe rajonale.

Është e qartë se miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe i Ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në vitin 2017, ishin hapa të rëndësishëm për mbrojtjen e duhur të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual¹¹. Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë,” Seksioni VI, Krimet Seksuale, konkretisht nenet 100 – 108, parashikon veprat penale kundër dhunës dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve¹². Me ndryshimet e fundit të vitit 2013, me anë të Ligjit Nr. 144/2013, dënimet penale për autorët e krimeve seksuale ndaj fëmijëve janë ashpërsuar. Dhuna seksuale parashikohet si vepër penale në Kodin Penal të Shqipërisë. Gjithashtu, Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili garanton një kuadër ligjor për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima dhe/ose dëshmitarë të veprave penale dhe parandalon riviktimizim/viktimizimin për herë të dytë të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale. Në lidhje me dhunën seksuale, ky ligj ka një nen të posaçëm (Neni 41 “Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale”), i cili rregullon pyetjen e fëmijëve dhe adoleshentëve dëshmitarë ose viktima të dhunës seksuale.

Deri më tani, Kodi Penal i Shqipërisë nuk parashikon asnjë përkufizim të termit “marrëdhënie seksuale”. Në Seksionin IV “Krimet Seksuale”, ka 5 nene që mbulojnë marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me fëmijë/të mitur, konkretisht nenet 100, 101, 103, 105 dhe 106, por mungon përkufizimi i termit “marrëdhënie seksuale”.

Sipas legjislacionit shqiptar, mosha e fëmijës është përcaktuar nën tetëmbëdhjetë vjeç, si në Ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ashtu edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), ndërsa mosha e pëlqimit seksual është rregulluar nga Neni 100 i Kodit Penal, në të cilit mosha e përcaktuar është katërmëdhjetë vjeç. Në lidhje me ligjshmërinë e marrëdhënieve seksuale konsensuale ndërmjet dy personave nën kufirin e moshës, Kodi Penal parashikon përfshirjen në aktivitetet ... seksual ... me një të mitur e cila nuk ka arritur pjekurinë seksuale.... (Neni 100, pika 1). Pra, neni rrit moshën e pëlqimit seksual për femrat që në moshën katërmëdhjetë vjeç nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, që është një vlerësim diskrecionar rast pas rasti.

Legjislacioni përkatës përfshin KDF-në (Konventën për të Drejtat e Fëmijës), Protokollin Opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, Konventën e Budapestit dhe Konventën e Lanzarotës¹³. Gjithashtu, ka edhe disa dispozita të Kodit Penal (KP) të Shqipërisë që trajtojnë Shfrytëzimin dhe Abuzimin Seksual të Fëmijëve (veprat penale të SHASF-së). Çështjet lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, korrupsionin e fëmijëve, joshjen e fëmijëve për qëllime seksuale, prostitucionin me fëmijë, pornografinë me fëmijë dhe aktet pornografike të fëmijëve janë

11 Republika e Shqipërisë. (2017). Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i disponueshëm në: <https://www.unicef.org/albania/media/2596/file/KODI%20-%20botimi%20dhjetor%202019.pdf>; Republika e Shqipërisë. (2017). Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i disponueshëm në: <https://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2017/06/Law-No-18-2017-On-the-rights-and-protection-of-the-child.pdf>

12 Republika e Shqipërisë. (2017). Kodin Penal, i disponueshëm në: <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=11&catid=10&m=0>

13 Shqipëria ratifikoi KDF-në me anë të Ligjit Nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”. Gjithashtu, ajo ratifikoi OPSC-në me anë të Ligjit Nr. 9834, datë 22.11.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës lidhur me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë”. Vendi ratifikoi Konventën e Budapestit me anë të Ligjit Nr. 8888, datë 25.4.2002, “Për ratifikimin e konventës për krimin kibernetik dhe Konventën e Lanzarotës me anë të Ligjit Nr. 10 071, datë 9.2.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

çështje që përfshihen në Kod. Aktet pornografike të fëmijëve rregullohen me nenin 117 (3) të KP-së. Ai përfshin të gjitha elementet e veprës penale të identifikuar nga standardet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht për përputhet me këto të fundit. Megjithatë, mungesa e përkufizimit të akteve pornografike, së bashku me mungesën e përkufizimit të pornografisë me fëmijë, mund ta kufizojë zbatimin e nenit. Neni 117 i KP-së parashikon si krim dy lloje sjelljesh lidhur me pornografinë: “ekspozimi i fëmijëve ndaj materialeve pornografike”, që parashikohet si krim nga Neni 117 (1) i KP-së, dhe “Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë me fëmijë, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë”, që parashikohet si krim nga Neni 117 (2) i KP-së. Ky i fundit është vepër penale e pornografisë me fëmijë e dënueshme sipas standardit të identifikuar ndërkombëtar. Mungesa e përkufizimit të pornografisë me fëmijë nga Kodi Penal i Shqipërisë sjell mungesën e dekriminalizimit të imazheve seksuale të vetëgjeneruara të fëmijëve, nën posedimin e këtyre të fundit me pëlqimin e tyre dhe vetëm për përdorimin e tyre privat.

Deri më tani, konventat ndërkombëtare dhe legjislacioni vendas janë përqendruar te rregullimi i formave klasike të SHASF-së, të ashtuquajturat vepra penale të abuzimit me kontakt, përfshirë, ndër të tjera, forma të ndryshme të abuzimit seksual dhe prostitucionit me fëmijë. Megjithatë, legjislacioni ka njohur dhe rregulluar disa forma të abuzimit pa kontakt, si ngacmimi seksual dhe korrupsioni i fëmijëve. Posedimi (përfshirë marrjen e aksesit) dhe shpërndarja e MASF-ve është e paligjshme¹⁴.

14 ECPAT International. (2020). BRIEFING PAPER ON THE SEXUAL EXPLOITATION OF CHILDREN IN ALBANIA., i disponueshëm në <https://ecpat.org/wp-content/uploads/2021/05/ECPAT-Briefing-Paper-on-the-Sexual-Exploitation-of-Children-in-Albania-2020-ENGLISH.pdf>.

2. METODOLOGJIA

2.1. HARTIMI I STUDIMIT

Ky studim ndoqi një qasje sasiore, duke synuar fëmijët e moshës 9 deri në 11 vjeç, në përputhje me moshën e synuar të projektit. Anketa u zhvillua në internet, me klasa ekzistuese fëmijësh.

2.2. KAMPIONIMI

U përdor kampionim i *qëllimshëm dhe i volitshëm*, i cili synonte fëmijët e moshës 9-11 vjeç, në zonat rurale dhe urbane, me qëllim përfshirjen e fëmijëve me të gjitha karakteristikat dhe prejardhjet (si fëmijë nga grupe minoritare, me statuse të ndryshme socio-ekonomike, etj.). Numri përfundimtar i fëmijëve pjesëmarrës në anketë ishte $n=1085$. Qasja e kampionimit u përzgjedh për të siguruar përfaqësim të larmishëm të fëmijëve, duke përfshirë fëmijë nga prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, vendndodhje gjeografike dhe kontekste kulturore. Kampioninimi i qëllimshëm u lejoi studiueseve që të përfshinin qëllimisht fëmijë nga grupe minoritare dhe statuse të ndryshme socio-ekonomike, duke rritur në këtë mënyrë gjithëpërfshirjen dhe përfaqësimin e kampionit. Kjo qasje ndihmoi për të siguruar se gjetjet, edhe pse nuk mund të përgjithësohen për popullatën e gjerë të fëmijëve, janë mjaftueshëm të forta për të kuptuar tendencat lidhur me temën e studimit. Madhësia përfundimtare e kampionit prej 1085 pjesëmarrësish ofroi mundësi të mjaftueshme për analizë statistikore, duke i mundësuar ekipit të studimit që të dalë në përfundime domethënëse nga të dhënat e mbledhura.

2.3. INSTRUMENTI I KËRKIMIT

Për qëllimet e këtij studimi u përdor një pyetësor, që do iu shpërnda fëmijëve në internet në klasat përkatëse.

Pyetësori ishte hartuar duke u bazuar te metodologjia e mirënjohur dhe studimi i Global Kids Online¹⁵. Ai u rishikua nga ekipi i eksperteve disa herë dhe pësoi ndryshime sa i përket gjuhës së përdorur për të qenë më miqësor me fëmijët, si dhe gjatësisë së tij.

Përpara administrimit përfundimtar, pyetësori u pilotua nëpërmjet një interviste kognitive me 10 fëmijë të moshës 9 deri në 11 vjeç dhe, pas marrjes së përshtypjeve të tyre, u rishikua dhe u finalizua.

Pyetësori u administrua në formatin “Google Forms” sepse fëmijët janë zakonisht më të njohur me këtë lloj platforme dhe ajo është më e përshtatshme për celularin.

¹⁵ Shihni <http://globalkidsonline.net/results/>

2.4. ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve u eksportuan në SPSS 26, u pastruan nga rastet e veçuara dhe u analizuan. Ky program u mundësoi një panoramë më të qartë të të dhënave dhe u dha përgjigje pyetjeve kërkimore. Analiza e përdorur ishte: statistika përshkruese (shpeshësitet, përqindjet) dhe tabelimet e kryqëzuara të bazuara në gjini, moshë dhe zona urbane-rurale.

2.5. KONSIDERATAT ETIKE

Studimi përfshiu konsiderata etike për shkak të angazhimit me persona të cënueshëm, sidomos fëmijë të moshës 9-11 vjeç. Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, Komiteti i Etikës i KMOP-së (Qendra për veprim social dhe inovacion) shqyrtoi protokollin e kërkimit për të siguruar përputhjen me standardet etike, duke u përqendruar te mbrojtja e pjesëmarrësve nga dëmtimi. Ky shqyrtim konfirmoi se procedurat ishin në përputhje me udhëzimet etike, përfshirë pëlqimin e informuar, minimizimin e ankthit dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës, siç theksohet nga Priebe et al (2010). Intervistuesit e terrenit dhe stafi mbështetës ndoqën trajnim për këto standarde etike për të siguruar se i kuptonin procedurat për marrjen e pëlqimit të informuar, pëlqimit të fëmijës dhe për zbatimin e mekanizmave të referimit për fëmijët që shfaqin shenja ankthi.

Parimet kryesore që drejtojnë studimin përfshijnë marrjen e pëlqimit të informuar si nga prindërit ashtu edhe nga fëmijët. Fëmijët e treguan pëlqimin e tyre nëpërmjet një platforme në internet dhe u informuan për të drejtën e tyre për t'u tërhequr në çdo moment pa pasur pasoja. Në rast shqetësimesh emocionale ose përvojash të pazbuluara të abuzimit në internet, fëmijëve u jepet një listë e detajuar e shërbimeve vendore mbështetëse dhe e linjave kombëtare të ndihmës. Prindërit morën një fletë informuese dhe formularin e pëlqimit duke u siguruar se nuk do të ushtrohej asnjë lloj shtrëngimi ndaj tyre. Pjesëmarrësit u informuan plotësisht për pjesëmarrjen e vullnetshme në anketë dhe për të drejtën e tyre për t'u larguar pa pasur pasoja. Studime të mëparshme, si ai i Priebe et al. (2010), tregojnë se disa tema anketimi, sidomos ato lidhur me çështje të ndjeshme, mund t'u shkaktojnë fëmijëve parehati; megjithatë, ndjekja e udhëzimeve etike, siç theksohet nga Guerra dhe Pereda (2015), minimizon ankthin dhe siguron që fëmijët të ndihen të mbështetur gjatë gjithë procesit¹⁶.

Privatësisë dhe konfidencialitetit iu dha përparësi duke përdorur metoda të mbledhjes së të dhënave në mënyrë anonime, me masa specifike për të mbrojtur të dhënat dhe për të ruajtur konfidencialitetin, përveç rasteve të raportimit të detyrueshëm lidhur me abuzimin ose vetëlëndimin e fëmijës. Protokollat për mbrojtjen e të dhënave garantuan sigurinë e të dhënave nëpërmjet ruajtjes së sigurt online, aksesit të kufizuar dhe mbrojtjes me fjalëkalim. Pas studimit, të dhënat u fshinë pas analizës, me kopje rezervë që do të mbahen nga Save the Children në përputhje me politikat e ruajtjes së të dhënave për të paktën tre vjet. Gjithashtu, të dhënat nga Barbovschi, Green, dhe Vandoninck (2013) për sfidat metodologjike dhe etike të kërkimit mbi njohjen e risqeve në internet ishin të rëndësishme për përcaktimin e masave mbrojtëse të studimit¹⁷. Ky kuadër siguroi një qasje

16 Priebe, G., Backstrom, M., & Ainsaar, M. (2010). Vulnerable adolescent participants' experience in surveys on sexuality and sexual abuse: Ethical aspects [Përvoja e pjesëmarrësve adoleshentë të cënueshëm në anketat rreth seksualitetit dhe abuzimit seksual: Aspektet etike]. *Child Abuse & Neglect* [Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve]: The International Journal, 34 (6), 438–47; Guerra, C., & Pereda, N. (2015). Research with adolescent victims of child sexual abuse: Evaluation of emotional impact on participants [Studimi me adoleshentët viktime të abuzimit seksual me fëmijë: Vlerësimi i ndikimit emocional te pjesëmarrësit]. *Journal of Child Sexual Abuse* [Revista e Abuzimit seksual të fëmijëve], 24 (8), 943–58.

17 Barbovschi, M., Green, L., & Vandoninck, S. (2013). Innovative approaches for investigating how children understand risk in new media: dealing with methodological and ethical challenges [Qasjet novatore për hetimin e mënyrës se si fëmijët kuptojnë rrezikun në median e re: trajtimi i sfidave metodologjike dhe etike]. Londër: EU Kids Online, LSE.

të përgjegjshme në aspektin etik për mbledhjen dhe administrimin e informacionit të ndjeshëm nga pjesëmarrësit fëmijë.

2.6. RISQET DHE KUFIZIMET

Sikurse në çdo studim, edhe për këtë studim paraqiten një sërë risqesh kryesore dhe kufizimesh të mundshme, që do të lehtësohen deri në masën e mundshme.

Risku për mospjesëmarrje. Kishte një risk të mundshëm që disa fëmijë mund të mos merrnin pjesë, gjë që do të sillte të dhëna të paplota dhe me gjasë pyetje kërkimore pa përgjigje. Për të pakësuar këtë risk, pas dorëzimit të konfirmimit etik filloi rrjetëzimi dhe planifikimi i hershëm, përfshirë diskutimet e rregullta me palët e interesit dhe angazhimin në mënyrë proaktive me shkollat. Drejtorët e shkollave, mësuesit dhe punonjësit psikosocialë i informuan prindërit për studimin dhe administruan shpërndarjen dhe mbledhjen e formularëve të pëlqimit.

Risku i të mos kuptuarit të pyetjeve: Disa formulime në pyetësor mund të kenë qenë të vështira për fëmijët, gjë që mund të ketë sjellë keqinterpretim ose pyetje të anashkaluara. Për të trajtuar diçka të tillë, pyetësori, i përshtatur nga instrumenti i testuar Global Kids Online, iu nënshtrua disa rishikimeve miqësore me fëmijët dhe u pilotua me 10 fëmijë. Gjithashtu, stafi i shkollës u trajnua për t'i ndihmuar fëmijët që të kuptojnë pyetjet e vështira.

3. GJETJET


Numri total i të fëmijëve të anketuar është $n=1085$. Të dhënat demografike treguan përfaqësim të ekuilibruar ndërmjet grupmoshave të ndryshme, me 26% të të anketuarve të jenë 9-vjeçarë, 35% të jenë 10-vjeçarë dhe 39% të tyre 11-vjeçarë. Në lidhje me gjininë, anketa përfshiu 52% djem, 48% vajza, dhe 0.3% që nuk dëshironin të përgjigjeshin. Gjithashtu, 79% e fëmijëve jetonin në zona urbane, ndërsa 21% jetonin në zona rurale.

Tabela 1. Mosha, gjinia dhe shpërndarja gjeografike e kampionit		
Mosha	9 vjeç	26%
	10 vjeç	35%
	11 vjeç	39%
Gjinia	Djal	52%
	Vajzë	48%
	Nuk dëshiroj të përgjigjem	0.3%
Vendbanim urban-rural	Urban	79%
	Rural	21%


88% e fëmijëve të anketuar treguan se jetojnë me të dy prindërit, ndërsa 9% raportuan se jetonin me një prej prindërve. 1% e fëmijëve pohuan se nuk jetojnë me asnjë prej prindërve, dhe 2% përzgjedhën alternativën “Tjetër” për të përshkruar mjedisin e tyre shtëpiak.

3.1. KOHA E SHPENZUAR PËRPARA EKRANIT NË INTERNET DHE SJELLJET E RREZIKSHME

Grafiku 1 tregon se 6% e fëmijëve raportuan se nuk e kishin përdorur kurrë internetin, gjë që tregon se një pjesë e vogël e kësaj grupmoshe nuk ka aktivitet në internet. 10% e përdorin internetin një ose më shumë herë në muaj, çka tregon përdorim rastësor. 26% e të anketuarve e përdorin internetin çdo javë, çka tregon për përdorim mesatar. Grupi më i madh, 57%, raportoi për përdorim të përditshëm të internetit, gjë që tregon se më shumë se gjysma e fëmijëve kanë akses të rregullt ditor në internet. Ky përdorim i lartë ditor thekson rëndësinë e internetit në jetën e përditshme të fëmijëve, por edhe nevojën e madhe për një mjedis të sigurt në internet. Për sa u përket tendencave ndërmjet djemve dhe vajzave, duket se vajzat janë më të prirura për ta përdorur internetin më shumë herë gjatë javës, ndërsa djemtë gjatë ditës. Nuk u vunë re dallime të tjera lidhur me moshën ose vendbanimin.



40% e fëmijëve treguan se kanë akses në internet nga një pajisje personale, si celulari, tableti ose laptopi i tyre. Nga ana tjetër, 60% e fëmijëve të anketuar raportuan se kanë akses në internet nga një pajisje e përbashkët familjare. Megjithatë kjo shifra e fundit tregon se shumica e fëmijëve bazohen në pajisje në pronësi të familjes për aksesin e tyre në internet, gjë që mund të ndikojë në nivelin e tyre të varësisë kur përdorin internetin, nga ana tjetër, për 40% të fëmijëve që zotërojnë pajisjet e tyre personale, siguria kur përdorin internetin mund të jetë më e ulët (Grafiku 2). 7% vajza zotërojnë pajisjet e tyre personale për të hyrë në internet, dhe është interesante se 14% e fëmijëve 9-vjeçarë kishin pajisjet e tyre personale. Nuk kishte dallime të ndjeshme ndërmjet pjesëmarrësve nga zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale.




Grafiku i mëposhtëm (Grafiku 3) paraqet një tablo të kohës që fëmijët në këtë anketë kalojnë për aktivitete të ndryshme në internet gjatë një dite të zakonshme, me disa tendenca të reja shqetësuese lidhur me përdorimin e internetit.


- **Media sociale:** 50% e fëmijëve raportuan se kalojnë deri në 1 orë në ditë në mediat sociale, ndërsa 25% kalojnë nga 1 deri në 3 orë. Megjithatë zakonisht përdorimi është mesatar, vlen të përmendet se 7% e fëmijëve kalojnë mbi 3 orë në ditë në mediat sociale, gjë që mund t'i ekspozojë ndaj ndikimeve negative, si bullizmi kibernetik, pritshmëritë sociale jorealiste dhe varësia e mundshme. Gjithashtu, 18% e fëmijëve nuk i përdorin fare mediat sociale. Për sa u përket dallimeve gjinore, 14% e djemve kalojnë më shumë kohë në mediat sociale (mbi 1 orë

në ditë). Për të tepër, përdorimi i mediave sociale rritet me rritjen e moshës, pra 11-vjeçarët kalojnë më shumë kohë në media sociale, ndërkohë që nuk ka dallime të ndjeshme midis zonave urbane dhe atyre rurale.


- **Detyrat e shtëpisë:** 52% e fëmijëve e përdorin internetin për detyrat e shtëpisë deri në 1 orë në ditë dhe 28% e përdorin atë për 1 deri në 3 orë çdo ditë. Megjithëse përdorimi për qëllime edukative është përgjithësisht pozitiv, 7% e fëmijëve raportojnë se kalojnë mbi 3 orë në internet për detyrat e shtëpisë, çka mund të tregojë varësi të mundshme të madhe nga mjetet digjitale dhe më pak angazhim në format e tjera të të nxënës. Nga ana tjetër, 13% e atyre që nuk e përdorin internetin për detyra shtëpie mund të humbasin burime të vlefshme edukative në internet. Megjithëse nuk ka dallime gjinore ose ndërmjet zonave urbane dhe rurale, 11-vjeçarët e përdornin atë më shumë për detyra shtëpie (12% e përdornin internetin për detyra shtëpie nga 1 deri në 3 orë në ditë).
- **Lojërat:** Të dhënat tregojnë se 59% e fëmijëve kalojnë deri në 1 orë duke luajtur dhe 16% raportojnë se luajnë 1 deri në 3 orë në ditë. 5% e fëmijëve kalojnë mbi 3 orë duke luajtur, gjë që mund të ketë ndikim negativ në shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Edhe në këtë rast, djemtë kalojnë më shumë kohë në internet për të luajtur në krahasim me vajzat (18% më shumë e djemve kalojnë mbi 1 orë në ditë). Mosha dhe vendbanimi nuk luajnë asnjë rol në këtë rast.
- **Konsolë lojërash:** Shumica (63%) e fëmijëve nuk përdorin konsola lojërash, gjë që mund të kufizojë ekspozimin e tyre ndaj disa efekteve negative lidhur me lojërat me konsolë, si reduktimi i ndërveprimeve sociale ose aktivitetit fizik. Megjithatë, 24% kalojnë deri në 1 orë dhe 8% luajnë për 1 deri në 3 orë. Për 5% që e përdorin atë mbi 3 orë, mund të ketë sërish ndikime negative, si reduktimi i kohës për aktivitete të tjera dobiprurëse, si për shembull lojërat jashtë, leximi, ose ndërveprimet me familjen. 29% e djemve dhe 10% e 9-vjeçarëve të këtij studimi i përdornin konsolat e lojërave mbi 1 orë në ditë. Nuk u vërejtën dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale.



Grafiku 4 ilustron përfshirjen e prindërve në përvojat e fëmijëve në internet. 85% e fëmijëve pjesëmarrës raportuan se prindërit ose kujdestarët e tyre e dinë se çfarë bëjnë fëmijët e tyre në internet ose kur përdorin mediat sociale, ndërsa 7% e tyre deklaruan se prindërit nuk e dinë dhe 8% treguan se prindërit e tyre kishin dijeni deri në njëfarë shkalle. Gjithashtu, 87% e fëmijëve pohuan se prindërit e tyre e dinë se *me kë* ata kalojnë kohën e tyre në internet, 6% pohuan se prindërit e tyre nuk kanë dijeni dhe 6% raportuan se prindërit e tyre kanë pak dijeni. Këto të dhëna tregojnë se shumica e prindërve ose kujdestarëve në këtë anketë i monitorojnë në mënyrë aktive ndërveprimet dhe aktivitetet e fëmijëve të tyre në internet. Nga ana tjetër, 12%-15% e fëmijëve raportojnë se prindërit e tyre nuk janë fare në dijeni për aktivitetet e fëmijëve të tyre në internet. 8% e vajzave pohuan se prindërit e tyre e dinin se çfarë bënin ato në internet dhe 5% e dinin se me kë ato e kalonin kohën në internet. Në një përqindje të vogël (5%), 9-vjeçarët ndanin më pak informacion me prindërit për aktivitetet që ata bënin në internet. Gjithashtu, më pak fëmijë nga zonat rurale pohuan se prindërit e tyre e dinin se me kë ata kalonin kohë në internet (9%).



Në përputhje me rezultatet e mësipërme, 74% e fëmijëve raportuan se ata flasin me prindërit e tyre për gjithçka që bëjnë në internet pa fshehur asgjë. Megjithatë, në këtë rast, 21% treguan se ata flasin me prindërit pothuajse për gjithçka, por i mbajnë disa gjëra private. Ndërkohë, 5% e fëmijëve pohuan se nuk u tregojnë prindërve asgjë për aktivitetet e tyre në internet. (Grafiku 5). Kjo tregon se shumica e fëmijëve kanë komunikim të hapur me prindërit e tyre lidhur me përdorimin e internetit, edhe pse një pjesë e konsiderueshme mbajnë ende informacioni për vete ose nuk komunikojnë aspak me prindërit. Vajzat dhe fëmijët nga zonat urbane ishin më të prirë për të folur më shumë me




prindërit se çfarë bënin në internet (9% më shumë vajza krahasuar me djemtë dhe 5% më shumë e fëmijëve nga zonat urbane në krahasim me ata nga zonat rurale). Mosha nuk luajti asnjë rol në këtë rast.

Shpeshtësia e sjelljeve të rrezikshme në internet gjatë vitit të shkuar paraqitet në Grafikon 6. Sikurse vërehet në grafik:

- **Kërkimi për shokë të rinj në internet:** 66% e fëmijëve pohuan se kurrë nuk kishin kërkuar për shokë të rinj në internet. Megjithatë, 18% kishin kërkuar një herë ose dy herë gjatë vitit të shkuar, ndërsa në përqindje më të vogla (8%, 4%, dhe 5%), fëmijët raportuan se kishin kërkuar më shpesh, gjë që tregon se disa fëmijë përfshihen në sjellje të rrezikshme në internet. 25% e djemve kishin kërkuar për shokë të rinj të paktën një herë gjatë vitit të shkuar. Fëmijët 9 vjeç (9%) dhe fëmijët nga zonat urbane (6%) kërkonin për shokë të rinj çdo javë ose çdo ditë.
- **Dërgimi i informacioneve personale:** Shumica dërmuese (95%) e fëmijëve raportuan se nuk kishin dërguar kurrë informacione personale në internet, çka tregon ndërgjegjësim të madh për risqet e privatësisë. Vetëm 3% e tyre kishin dërguar informacione personale vetëm një herë ose dy herë, dhe 1% kishin dërguar më shpesh, gjë që tregon angazhim shumë të kufizuar në ndarjen e të dhënave personale. Lidhur me këtë veprim, nuk ka dallime të konsiderueshme ndërmjet gjinisë, moshës ose zonave urbane dhe rurale.
- **Shtimi i personave të panjohur te kontaktet:** 80% e fëmijëve treguan se nuk kishin shtuar kurrë persona që nuk i kishin takuar ballë për ballë në listat e tyre të kontaktit, gjë që tregon kujdes se kë pranojnë si shokë në internet. Megjithatë, 11% kishin shtuar vetëm një herë ose dy herë, dhe në përqindje më të vogla (5%, 2%), fëmijët ishin angazhuar në këtë sjellje më shpesh, çka tregon se një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve lidhet me individë të panjohur. Më shumë djem sesa vajza (10% më shumë dhe pak më të mëdhenj se 11 vjeç (4-5%)) ishin më shumë të predispozuar për të shtuar persona të panjohur në kontakte, ndërsa dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale nuk kishte.
- **Pretendimi për të qenë dikush tjetër në internet:** 88% e fëmijëve raportuan se kurrë nuk kishin pretenduar të ishin një person i ndryshëm në internet. Megjithatë, 8% e kanë bërë


Grafiku 6. Sa shpesh ke bërë një nga këto gjëra në internet ose në telefon vitin e shkuar?



këtë vetëm një herë ose dy herë, dhe një përqindje më e vogël fëmijësh (2%, 1%) e kishin bërë më shpesh, çka tregon se një numër i vogël fëmijësh mund të eksperimentojë me identitete të tjera, por njëkohësisht mund të jenë më të ekspozuar ndaj përmbajtjeve të dëmshme dhe komunikimit të rrezikshëm. Më shumë djem sesa vajza (6% më shumë) dhe më shumë 11-vjeçarë (6%) kanë pretenduar se kanë qenë dikush tjetër, ndërkohë që nuk ka dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

- **Dërgimi i fotografive ose videove të persona të panjohur:** Një përqindje e konsiderueshme (97%) e fëmijëve nuk u kanë dërguar kurrë fotografi ose video të tyre personave që nuk i kanë takuar kurrë, çka tregon një nivel të lartë kujdesi për privatësinë personale. Vetëm 2% e kishin bërë diçka të tillë një herë ose dy herë, dhe 1% ose më pak raportuan se e bënin diçka të tillë rregullisht, gjë që ilustron se kjo sjellje e rrezikshme është e rrallë te fëmijët. Lidhur me dërgimin e fotografive të persona të panjohur, nuk u vunë re dallime të rëndësishme ndërmjet gjinisë, moshës ose zonave urbane dhe rurale.

3.2. KOMUNIKIMI NË INTERNET



Grafiku i mësipërm tregon mënyrat e ndryshme se si fëmijët komunikojnë në internet me familjarët, shokët e tyre dhe personat që i kanë takuar vetëm në internet (Grafiku 7).

Komunikimi me familjen:

- Me motrat dhe vëllezërit: 48% e fëmijëve pohuan se nuk kishin komunikuar kurrë në internet me vëllanë ose motrën, ndërsa 21% e bënë këtë përditë. Kjo tregon një model të përzier, me disa fëmijë që nuk e shohin të nevojshme të komunikojnë në internet me motrat dhe vëllezërit, dhe me të tjerë që e bëjnë shpesh diçka të tillë. Megjithatë nuk ka dallime gjinore për komunikimin në internet me motrat dhe vëllezërit, 13% e fëmijëve 9 vjeç dhe 9% e fëmijëve nga zonat urbane e kanë përdorur këtë mënyrë komunikimi me motrat dhe vëllezërit e tyre.
- Me prindërit ose kujdestarët: 31% e fëmijëve nuk kanë komunikuar kurrë në internet me prindërit ose kujdestarët e tyre, ndërsa 40% e bëjnë përditë diçka të tillë. Megjithatë komunikimi i shpeshtë mund të tregojë lidhje pozitive, varësia nga mesazhet në vend të bisedave të bëra fizikisht tregon për më pak angazhim ballë për ballë. Më pak fëmijë 11-vjeçarë komunikojnë në internet me prindërit (13% më pak krahasuar me 9-vjeçarët), ndërsa 8% më shumë e fëmijëve nga zonat rurale komunikojnë në internet me babanë.
- Me të rritur të tjerë (p.sh., halla/tezja, xhaxhi/daja, gjyshërit): 43% e fëmijëve nuk kanë komunikuar kurrë në internet me anëtarët e familjes së zgjeruar, si hallat/tezet ose gjyshërit, ndërsa 10% e bënë këtë përditë. Komunikimi jo i shpeshtë mund të tregojë për marrëdhënie më të dobëta me familjen e zgjeruar. Në këtë rast nuk janë vënë re dallime të konsiderueshme gjinore, por 10% më shumë e 9-vjeçarëve dhe 6% më shumë e fëmijëve nga zonat urbane nuk komunikojnë në internet me të rriturit e tjerë.

Shokët dhe të njohurit:

- Me të njohur mbi **18 vjeç** që i kanë takuar ballë për ballë: 82% e fëmijëve nuk kanë komunikuar kurrë në internet me të njohur mbi 18 vjeç që i kishin takuar ballë për ballë. Nga ana tjetër, pothuajse **1 në 10** fëmijë komunikojnë të paktën një herë në muaj dhe disa prej tyre komunikojnë përditë me një person mbi 18 vjeç që i kishin takuar ballë për ballë. Komunikimi i kufizuar me të njohurit më të mëdhenj mund të tregojë për njohje të mirë të sigurisë në internet; megjithatë, për përqindjen e vogël që angazhohet shpesh, kjo gjë mund të sjellë risqe, sidomos nëse fëmijët nuk janë mjaftueshëm të informuar për privatësinë dhe sigurinë. 6% më pak e 9-vjeçarëve dhe 8% më pak e fëmijëve nga zonat rurale komunikojnë me persona që i kishin takuar ballë për ballë.
- Me shokë **nën 18 vjeç** që i kanë takuar ballë për ballë: 71% e fëmijëve pohuan se nuk kishin komunikuar kurrë me shokët nën 18 vjeç që i kishin takuar më parë ballë për ballë, e megjithatë 17% e tyre e bënin diçka të tillë të paktën një herë në muaj (6% e tyre komunikojnë përditë). 19% më pak e 9-vjeçarëve komunikojnë në internet me dikë nën 18 vjeç që i kishin takuar ballë për ballë, ndërkohë nuk kishte dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale.


Kontaktet vetëm nga interneti:

- Me dikë që e kanë njohur në internet për herë të parë, që ishte shoku i një shoku/familjari: 79% e fëmijëve nuk kishin komunikuar kurrë me dikë që e kishin njohur në internet nëpërmjet një shoku ose familjari, ndërsa vetëm 10% e tyre (1 nga 10 fëmijë) komunikojnë të paktën një herë në muaj. Megjithatë kjo sjellje e kujdesshme është pozitive, grupi i vogël që angazhohet me të njohur në internet mbetet i rrezikuar për t'u ekspozuar ndaj sjelljeve të papërshtatshme ose të rrezikshme në internet. 13% ishin të prirë për të pasur këtë lloj komunikimi të paktën një herë në vit ashtu si edhe 9% më shumë e fëmijëve nga zonat rurale. Në këtë rast, nuk kishte dallime moshore.


- Me dikë nën **18 vjeç** që e kanë njohur në internet, por pa lidhje të tjera: Ndërkohë që 90% e fëmijëve nuk kishin komunikuar kurrë me dikë nën 18 vjeç që e kishin njohur në internet, por pa lidhje të tjera, një pjesë e vogël fëmijësh (4%) e kishin bërë diçka të tillë të paktën një herë në muaj. Për shumicën, kjo tregon ndërveprim shumë të kufizuar me të panjohur, gjë që është pozitive. Megjithatë, për ata pak persona që angazhohen, këto sjellje mbartin kërcënime të mundshme, si ekspozimi ndaj bullizmit kibernetik ose ndjelljes. 9% ishin njohur me dikë në internet të paktën një herë në vit gjatë vitit të shkuar, ndërkohë që nuk kishte dallime për moshën dhe vendbanimin.
- Me dikë **mbi 18 vjeç** që e kanë njohur në internet, por pa lidhje të tjera: në këtë rast, përqindja e fëmijëve që komunikojnë të paktën një herë në muaj me një person që e kanë njohur në internet, pa lidhje të mëparshme, është edhe më e ulët (3%) dhe 2% e tyre e kishin bërë këtë një herë ose dy herë gjatë vitit të shkuar. Sërish, 5% më shumë djem ishin njohur me dikë në internet, por pa lidhje të tjera, të paktën një herë gjatë vitit të shkuar, dhe po të njëjtën gjë kishin bërë edhe 5% më shumë e fëmijëve nga zonat rurale.

Në përgjithësi, në lidhje me komunikimin e rrezikshëm në internet, 7-10% e fëmijëve angazhohen me të panjohur ose me të njohur vetëm nga interneti dhe mund të rrezikohen nga ekspozimi ndaj sjelljeve të dëmshme, përfshirë ndjelljen ose ngacmimin në internet. Gjithashtu, një përqindje e vogël por e konsiderueshme, deri në 10%, komunikojnë me individë që i kanë njohur për herë të parë në internet, gjë që mund të rrisë cenueshmërinë e tyre nga ndikimet negative, manipulimi dhe shfrytëzimi.

Sikurse shihet në Grafikon 8, 28% e fëmijëve kanë llogarinë e vet në një media sociale ose rrjetë sociale në internet, ndërsa 33% kanë një llogari në faqe lojërash në internet. Ndërkohë, 40% raportuan se nuk kanë llogari as në media sociale, as në platforma lojërash. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve po përdorin në mënyrë aktive dhe kanë llogari personale në platforma të njohura në internet. Djemtë kanë më shumë llogari në mediat sociale dhe në faqet e lojërave në internet në krahasim me vajzat. Duke treguar dallime moshore, dyfishi i 10-vjeçarëve kanë një llogari në mediat sociale dhe madje më shumë se 11-vjeçarët (përkatesisht 15% dhe 30%), por 9-vjeçarët kishin më shumë llogari më faqet e lojërave në internet (7% më shumë krahasuar me grupmoshat e tjera). Përsa i përket vendbanimit, 16% më shumë e fëmijëve nga zonat urbane kanë llogari në media sociale dhe në faqe lojërash.




Kur u pyetën për informacionet që përfshijnë në llogaritë e tyre në internet, shumica e fëmijëve u përgjigjën se nuk kishin informacione të ndjeshme, si adresat, numrat e telefonit ose shkollat (mbi 90% thanë “jo”). Megjithatë, fakti se 24% e fëmijëve e deklarojnë ndryshe moshën e tyre duke thënë se janë më të mëdhenj sesa janë realisht, dhe 19-23% ndajnë fotografitë, mbiemrin ose interesat, tregon se ende nevojitet më shumë ndërgjegjësim për risqet e ndarjes së informacioneve personale në internet (Grafiku 9). Djemtë kishin më shumë gjasa sesa vajzat për të ndarë informacione personale në internet: 7% më shumë e djemve përfshinin mbiemrin e tyre, 5% më shumë ndanin numrin e tyre të telefonit, 6% më shumë deklarorin shkollën, 8% më shumë deklarorin moshën e saktë, dhe 8% më shumë raportorin moshë më të madhe sesa mosha reale. 7% e 11-vjeçarëve kishin përfshirë mbiemrin e tyre, 7% e 11-vjeçarëve kishin dhënë numrin e tyre të telefonit, 7% e 9-vjeçarëve kishin vendosur moshën e tyre, dhe 11% e 11-vjeçarë raportuan moshë më të madhe sesa ishin aktualisht. Fëmijët nga zonat rurale ishin përgjithësisht më të prirë për të ndarë informacione personale në internet në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat urbane. Më konkretisht, 8% e fëmijëve nga zonat rurale përfshinin mbiemrin dhe hobin, 11% ndanin adresën e tyre, 7% deklarorin numrin e telefonit dhe moshën e saktë, dhe 6% raportorin moshë më të madhe sesa mosha reale. Kjo veçori tregon se fëmijët nga zonat rurale mund të kenë perceptim të ndryshëm për privatësinë në internet, me gjasë ndihen më pak të shqetësuar ose të informuar për risqet mbi privatësinë.



Sa u përket “kërkesave për miqësi” të dhënat tregojnë prirje shqetësuese për mënyrën se si fëmijët në këtë anketë veprojnë me kërkesat për miqësi. 8% e fëmijëve i pranojnë të gjitha kërkesat për miqësi ndërsa 12% i pranojnë nëse kanë miq të përbashkët, gjë që përbën rrezik të konsiderueshëm për ekspozimin ndaj personave të panjohur dhe rreziqe të mundshme si bullizmi kibernetik ose ndjellja. Është pozitive që 22% e tyre pranojnë kërkesa vetëm nga njerëz që i njohin dhe 18% pranojnë kërkesa vetëm nga njerëz që i njohin shumë mirë, gjë që tregon se janë disi të kujdesshëm. Vlen të theksohet se 40% e fëmijëve i pranojnë kërkesat vetëm me lejen e prindërve ose kujdestarëve të tyre, duke treguar se ka përfshirje prindërore për një numër të konsiderueshëm fëmijësh (Grafiku 10). Djemtë ishin më të prirë se vajzat për t’i pranuar të gjitha kërkesat për miqësi ose për të pranuar vetëm kërkesat nga persona që i njihni, por nuk kërkonin medoemos lejen e prindërve për këtë gjë.

Dallimet sipas moshës treguan prirje të ndryshme: 6% e fëmijëve 9 vjeç i pranonin të gjitha kërkesat për miqësi, ndërsa 8% e fëmijëve 9 vjeç i pranonin ato vetëm me lejen e prindërve. Nuk u vërejtën dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale për këtë pyetje.



Fëmijët e anketuar nuk ishin shumë të ndërgjegjësuar për veçoritë e sigurisë në internet dhe nuk i përdornin shumë ato, duke zbuluar se një numër i lartë fëmijësh nuk i njohin këto mjete të rëndësishme. 23% e fëmijëve, nuk e dinë se çfarë është butoni i bllokimit, ndërsa 22% nuk e kanë parë asnjëherë, pra, rreth **1 nga 2 fëmijë ose nuk e dinë se çfarë është veçoria e bllokimit ose nuk e kanë hasur asnjëherë**. 26% e fëmijëve nuk e dinë se çfarë është butoni i raportimit, ndërsa 25% nuk e kanë parë asnjëherë, pra, sërish, **1 nga 2 fëmijë nuk i njohin mjetet e raportimit të krijuara për t'i mbrojtur ata në internet**.


Është për t'u shqetësuar që 50% e fëmijëve nuk e dinë se çfarë janë qendra e ndihmës ose linku për linjën telefonike të ndihmës dhe, 33% nuk kanë i kanë parë ndonjëherë—kjo do të thotë se **4 nga 5 fëmijë nuk i kuptojnë ose nuk i kanë hasur asnjëherë burimet që mund t'i ndihmojnë në situata të vështira në internet**. Po ashtu, 48% e fëmijëve nuk i njohin qendrat e sigurisë dhe 30% nuk kanë parë ndonjëherë një të tillë, duke zbuluar se **4 nga 5 fëmijë nuk janë të ndërgjegjësuar për këto burime sigurie (Grafiku 11)**.

Vetëm 15% e kanë përdorur butonin e bllokimit, 10% e kanë përdorur butonin e raportimit, 3% kanë aksesuar një qendër ndihme dhe 4% kanë përdorur një qendër sigurie, duke treguar se përdorimi i mjeteve të sigurisë është i kufizuar (Grafiku 11).

Vajzat kishin më pak njohuri rreth mjeteve të sigurisë në internet sesa djemtë. Më specifikisht, 8% e vajzave nuk ishin në dijeni të veçorisë së bllokimit, 11% nuk kishin dëgjuar për butonin e raportimit dhe 5% nuk kishin njohuri rreth qendrës së ndihmës dhe qendrës së sigurisë. Kjo tregon se mund të ketë boshllëqe në ndërgjegjësimin ose edukimin e vajzave për veçoritë e sigurisë në internet, kështu ato mund të jenë më të cenueshme ndaj risqeve në internet.


Në krahasim me fëmijët 10 dhe 11 vjeç, një numër i konsiderueshëm fëmijësh 9 vjeç nuk ishin të ndërgjegjësuar për mjetet thelbësore të sigurisë në internet; 14% nuk ishin në dijeni të butonit të bllokut dhe mbi 20% nuk kishin njohuri për veçorinë e raportimit. Kjo gjë tregon se fëmijët më të vegjël, në veçanti, mund të jenë më të cenueshëm në internet.

Fëmijët nga zonat rurale kishin më pak njohuri rreth mjeteve të caktuara të sigurisë në internet; 9% nuk ishin në dijeni të veçorisë së bllokimit dhe 15% nuk kishin njohuri për opsionin e raportimit. Nuk kishte dallime ndërmjet fëmijëve që jetojnë në zona urbane dhe atyre që jetojnë në zona rurale sa u përket njohurive për mjetet e tjera të sigurisë. Ky boshllëk tregon se fëmijët që jetojnë në zonat rurale mund të jenë më pak të ekspozuar ndaj edukimit për sigurinë digjitale në krahasim me fëmijët që jetojnë në zonat urbane.




3.3. DËMET NË INTERNET

Grafiku i mëposhtëm tregon se si i perceptojnë fëmijët e anketuar përmbajtjet që i shqetësojnë apo i mërzhisin në internet. 39% e fëmijëve thanë se në internet ka gjëra që i mërzhisin ose i shqetësojnë, ndërsa 41% thanë se nuk kanë përjetuar ndonjëherë problematika të tilla. Ndërkohë, 20% e fëmijëve thanë se përmbajtjet në internet i kanë mërzhitur disi. Kjo tregon se ndonëse një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve nuk ndihen të shqetësuar nga përmbajtjet në internet, **rreth 4 nga 10 fëmijë ndihen të shqetësuar**, qoftë plotësisht ose deri diku, kur lundrojnë në internet. (Grafiku 12). Kur u pyetën se sa herë ishin shqetësuar apo mërzhitur gjatë vitit të shkuar, 77% e fëmijëve thanë se nuk kishin hasur ndonjëherë në internet diçka që i kishte shqetësuar, ndërsa 15% kishin përjetuar incidente të tilla vetëm një ose dy herë. 3% ishin përballur me situata shqetësuese çdo muaj, ndërsa



përqindje më të vogla ishin përballur çdo javë (1%) ose çdo ditë (4%). 1% e fëmijëve zgjodhën të mos i përgjigjeshin kësaj pyetjeje. Ndonëse shumica e fëmijëve nuk raportuan përvoja negative, një pjesë e konsiderueshme, 23%, përjetuan një nivel shqetësimi në internet (Grafiku 13).

Nuk u vërejtën dallime sipas moshës ose gjinisë për këto dy pyetje, por 9% më shumë e fëmijëve që jetojnë në zonat rurale raportuan se besonin që interneti përmbante gjera shqetësuese ose të mërzitshme për moshën e tyre.




Pyetjes së mëposhtme i janë përgjigjur vetëm fëmijët që kishin përjetuar të paktën një ndërveprim shqetësues në internet (n = 196 fëmijë). Sa u përket mënyraves si fëmijët përgjigjen ndaj incidenteve shqetësuese në internet, 43% e tyre e injoronin problemin, ndërsa 54% e mbyllnin aplikacionin në fund të ndërveprimit. Një pjesë e konsiderueshme, 41% ndienin faj për atë që kishte ndodhur. 44% ishin munduar ta bindnin personin tjetër t'i linte të qetë, ndërsa 15% ishin kundërpërgjigjur. 40% kishin ndaluar së përdoruri interneti përkohësisht, ndërsa 56% e kishin bllokuar personin tjetër. Megjithatë, vetëm 29% i ndryshuan konfigurimet e tyre të privatësisë dhe 27% e raportuan problematikën, gjë që tregon se shumë fëmijë nuk marrin masa proaktive për t'u mbrojtur ose për të kërkuar ndihmë gjatë përballjes me përvoja shqetësuese në internet (Grafiku 14).

Dallimet gjinore lidhur me përgjigjet ndaj problematikave në internet tregojnë prirje të veçanta: 12% e djemve e kishin injoruar problemin dhe 6% kishin dashur të hakmerreshin, ndërsa 9% e djemve ishin munduar ta bindnin personin tjetër t'i linte të qetë. Nga ana tjetër, 13% e vajzave zgjidhnin ta mbyllnin aplikacionin ose shfletuesin, 4% ndienin faj dhe 14% kishin ndaluar së përdoruri internetin për pak kohë. Gjithashtu, 7% e vajzave e kishin bllokuar personin tjetër. Nuk u vërejtën dallime sa i përket fshirjes së mesazheve ose ndryshimit të konfigurimeve të privatësisë.

Nga dallimet sipas moshës për përgjigjet ndaj problematikave në internet u vu re se kishte gjasa që fëmijët më të vegjël (9 vjeç) t'i injoronin problemet (8%) dhe të mundoheshin ta bindnin personin tjetër t'i linin të qetë (7% e 9-vjeçarëve). Gjithashtu, 13% e fëmijëve 9 vjeç e shmangën internetin për pak kohë, ndërsa 12% e fëmijëve 11 vjeç e bllokuan personin tjetër dhe 10% të tjerë e raportuan



problematikën. Zakonisht, konfigurimet e privatësisë ndryshoheshin më tepër nga 11-vjeçarët, me 12%. Në përgjithësi, nuk u gjetën dallime sa i përket fshirjes së mesazheve ose ndryshimit të konfigurimeve të privatësisë.

Në krahasim me fëmijët që jetojnë në zonat urbane, fëmijët nga zonat rurale përgjigjeshin ndryshe ndaj problematikave në internet: 16% e kishin injoruar problemin, 18% ishin ndierë në faj, 10% ishin përpjekur ta bindnin personin tjetër t'i linte të qetë dhe 14% i kishin fshirë mesazhet. Megjithatë, fëmijët nga zonat rurale kishin 11% më pak gjasa ta mbyllnin shfletuesin, 15% më pak gjasa t'i ndryshonin konfigurimet e privatësisë dhe 18% më pak gjasa ta raportonin problemin, por kishin 5% më shumë gjasa ta bllokonin personin. Kjo tregon se fëmijët në zonat rurale mund të mbështeten më shumë në mënyrat joformale të trajtimit të problematikave në internet dhe se kanë më pak ndërveprim me mjetet formale të sigurisë.




3.4. RISQET NË INTERNET

1 nga 10 fëmijë raportuan se kishin takuar ballë për ballë dikë që e kishin njohur në internet fillimisht, ndërsa shumica (85%) thanë se nuk e kishin bërë diçka të tillë (Grafiku 15). 5% e fëmijëve zgjodhën të mos i përgjigjeshin kësaj pyetjeje. Nga 100 fëmijët, të cilët e kishin takuar dikë ballë për ballë: 77% e tyre kishin takuar një person të moshës së tyre, 8% një person më të vogël, ndërsa 10% kishin takuar një adoleshent më të rritur se vetja dhe 5% kishin takuar një të rritur, gjë që ngre shqetësime për risqet e mundshme të sigurisë duke qenë se takimi me të rriturit mund të ketë risqe më të mëdha për fëmijët gjatë ndërveprimeve në internet. Djemtë dhe 11-vjeçarët ishin më të prirë të njihnin dikë në internet (me 5% më shumë për të dyja rastet). Ndonëse nuk kishte dallime të mëdha gjinore dhe sipas moshës për moshën e personit që ata kishin takuar ballë për ballë, duket se 11% e fëmijëve nga zonat rurale kishin takuar një të rritur (Grafiku 16).





Grafiku në vijim tregon se kë lajmëruan fëmijët në këtë anketë për planet e tyre kur takuan fizikisht një person që fillimisht e kishin njohur në internet. 1 nga 4 fëmijë nuk i treguan askujt se ku do të shkonin, gjë që është shqetësuese pasi shton risqet e mundshme. 17% lajmëruan një motër ose vëlla mbi 18 vjeç ose një shok/shoqe, ndërsa 14% i treguan babait dhe 10% i treguan nënës. 9% lajmëruan një motër ose vëlla më të vogël dhe një numër më i vogël fëmijësh i treguan dikujt tjetër ose një mësuesi (3% dhe 2%). 5% zgjodhën të mos përgjigjeshin. Të dhënat tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve nuk e tregojnë vendndodhjen e tyre, gjë që mund t'i vendosë në situata të pasigurta (Grafiku 17). Nuk pati dallime të mëdha gjinore apo sipas moshës për këtë rast, por 17% e fëmijëve nga zonat rurale nuk i kishin treguar askujt se ku do të shkonin, duke u bërë më të cenueshëm ndaj risqeve të mundshme.



1 nga 4 fëmijë të anketuar moshës 9 deri 11 vjeç janë ekspozuar të paktën një ose dy herë ndaj fotografive, videove ose shkrimeve të papërshtatshme në telefonat e tyre celularë ose në internet vitin e shkuar. Për 4% prej tyre kjo gjë ka ndodhur një herë ose më shumë gjatë një jave dhe për 2% prej tyre ka ndodhur disa herë gjatë ditës dhe djemtë kanë zgjedhur më shumë se një alternativë (Grafiku 18). Nuk pati dallime të tjera të konsiderueshme për këtë rast.


Pyetjes së radhës i janë përgjigjur vetëm fëmijë që ishin ekspozuar të paktën një herë ndaj një përmbajtje të papërshtatshme në internet ose në telefonat e tyre celularë (n=242). Siç shihet në




Grafikun 19, 30% e fëmijëve raportuan se kishin parë një fotografi ose video të një personi lakuriq, ndërsa 59% e tyre nuk kishin parë diçka të tillë dhe 11% zgjodhën të mos përgjigjeshin. 10% e fëmijëve kishin parë një imazh ose video me organet gjenitale të një personi, ndërsa 76% nuk kishin parë diçka të tillë dhe 14% nuk dëshironin të përgjigjeshin. Gjithashtu, 16% raportuan se kishin parë imazhe ose video me veprime të papërshtatshme që përfshinin njerëz lakuriq, ndërsa 72% nuk kishin parë diçka të tillë dhe 12% nuk dëshironin të përgjigjeshin. Nga këto gjetje zbulojmë se një numër i konsiderueshëm fëmijësh ekspozohen ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme në internet, nga 10% deri në 30%. Vajzat ishin pak më shumë të ekspozuara ndaj fotografive ose videove të një personi lakuriq ose të organeve intime (5% më shumë). 12 deri 16% e fëmijëve 11 vjeç ishin ekspozuar ndaj të tria llojeve të përmbajtjes së dëmshme në internet dhe 20% më shumë e fëmijëve nga zonat rurale ishin ekspozuar ndaj një fotografie ose videoje të një personi lakuriq.

Grafiku i radhës tregon ekspozim shqetësues të fëmijëve ndaj përmbajtjeve të dëmshme në internet gjatë vitit të shkuar (Grafiku 20). 18% e fëmijëve kanë hasur mesazhe urrejtjeje që synonin grupe specifike, gjë që tregon se pothuajse 1 nga 5 fëmijë janë të ekspozuar ndaj materialeve të dëmshme dhe diskriminuese. 16% e fëmijëve kanë parë materiale me mënyra për të qenë shumë të dobët, gjë që mund të ketë ndikuar negativisht në imazhin e fëmijëve për trupin e tyre dhe në shëndetin e tyre mendor. 7% e fëmijëve kanë parë materiale të lidhura me vetëlëndimin, ndërsa 7% kanë parë imazhe

me përmbajtje dhune dhe gjaku. Gjithashtu, 4% janë ekspozuar ndaj përmbajtjeve për vetëvrasjen dhe 4% kanë hasur materiale të lidhura me përdorimin e drogave. U vunë re dallime gjinore dhe dallime sipas vendbanimit sa i përket rastit të ekspozimit ndaj mesazheve të urrejtjes (6% më shumë djem dhe 10% më shumë fëmijë nga zonat urbane).




Sa u përket risqeve në internet dhe kërcënimeve kibernetike, 12% e fëmijëve thanë se pajisja e tyre kishte marrë virus ose ishte përgjuar, gjë që tregon se ka cenueshmëri ndaj kërcënimeve kibernetike. 7% pranuan se shpenzonin shumë para për lojërat në internet ose blerje në aplikacione dhe kjo gjë mund të përbëjë risk financiar nëse nuk ushtrohet kontrolli i duhur. 6% raportuan se dikush kishte krijuar një faqe ose video lënduese për ta, gjë që tregon ekspozim ndaj ngacmimeve në internet. 4% thanë se dikush kishte përdorur fjalëkalimin e tyre për të aksesuar informacione rreth tyre dhe për t'u hequr si ata, duke ngritur shqetësime rreth sigurisë së fjalëkalimeve. Vetëm 2% raportuan se dikush kishte përdorur të dhënat e tyre në një mënyrë që nuk u kishte pëlqyer, ndërsa 1% ishin gjurmuar përmes telefonit ose pajisjes së tyre, duke treguar se ka shkelje të privatësisë (Grafiku 21). Nuk u vërejtën dallime gjinore, dallime sipas moshës ose dallime të tjera për këtë rast.




Në vijim të pyetjes së mëparshme, sa i përket ngacmimit seksual në internet, 8% e fëmijëve raportuan se kishin marrë mesazhe të papërshtatshme, qoftë me fjalë, imazhe apo video, ndërsa 90% nuk e kishin përjetuar ndonjëherë diçka të tillë. 3% të fëmijëve u ishin kërkuar informacione të

papërshtatshme personale, si detaje rreth mënyrës se si vishen, ndërsa 3% të fëmijëve u ishte bërë presion për të dërguar imazhe ose video të papërshtatshme të vetes. Po ashtu, 3% e fëmijëve kishin parë fotografi ose video të një personi tjetër lakuriq. Ndonëse pjesa më e madhe e fëmijëve nuk ishin përballur me përvoja të tilla, 3-8% e atyre që ishin përballur janë të ekspozuar ndaj risqeve të mëdha në internet. Nuk u vërejtën dallime gjinore, dallime sipas moshës, apo dallime të tjera lidhur me këtë pyetje.




Kur u pyetën për personat me të cilët bisedonin për këto incidente, 33% e fëmijëve thanë se flisnin me një shok/shoqe, pra, kjo ishte alternativa më e përzgjedhur. 30% flisnin me nënën e tyre dhe 26% flisnin me babanë. 23% e fëmijëve flisnin me të afërm të tjerë të rritur si hallat/tezet, xhaxhallarët/dajat ose gjyshërit, ndërsa 18% flisnin me një motër ose vëlla nën 18 vjeç. Një numër më i vogël fëmijësh zgjidhnin të flisnin me persona të tjerë—12% e fëmijëve flisnin me një motër ose vëlla më të madh, 14% me një mësues dhe 7% me një të rritur që i besonin, si për shembull një trajnues



ose mjek. Vlen theksohet se 16% e fëmijëve nuk flisnin me askënd dhe 12% zgjedhën të mos i përgjigjeshin pyetjes. Në krahasim me 9 dhe 10-vjeçarët, fëmijët 11 vjeç kishin më shumë gjasa të flisnin me nënën e tyre ose me një shok/shoqe. 6% e fëmijëve nga zonat rurale nuk flisnin me askënd për këtë përvojë.

Sa u përket veprimeve të tyre pas përballjes me një situatë shqetësuese në internet, 28% e fëmijëve e kishin bllokuar personin tjetër në mënyrë që të mos i kontaktonte më dhe kjo ishte përgjigja më e zakonshme. 24% kishin zgjedhur të mbyllnin shfletuesin ose aplikacionin, ndërsa 20% kishin ndaluar së përdoruri internetin për pak kohë ose kishin fshirë mesazhet e dërguara nga personi tjetër. 18% ishin munduar ta bindnin personin tjetër t'i linte të qetë, ndërsa 17% kishin ndierë faj për atë që kishte ndodhur. 14% kishin zgjedhur ta injoronin problemin ose kishin ndryshuar konfigurimet e privatësisë, dhe 15% e kishin raportuar incidentin në internet. Një numër i vogël fëmijësh (10%) ishin përpjekur të hiqnin dorë nga përdorimi i internetit. Shumica e fëmijëve kishin zgjedhur të mos ndërmerrnin veprime si raportimi apo rregullimi i konfigurimeve të privatësisë (Grafiku 24). Sa u përket dallimeve gjinore, djemtë ishin më të prirë t'i trajtonin direkt problematikat në internet: 20% e kishin injoruar problemin, 8% ishin përpjekur ta bindnin personin tjetër t'i linte të qetë dhe 7% ishin përpjekur të hiqnin dorë nga përdorimi i internetit. Nuk u identifikuan dallime të tjera për këtë rast.



4. PËRFUNDIME

4.1. SJELLJET E FËMIJËVE NË INTERNET

Nga gjetjet u zbulua se fëmijët në këtë studim janë shumë të përfshirë në botën digjitale dhe 57% e tyre e aksesojnë internetin çdo ditë. Ky akses i rregullt tregon se sa e rëndësishme është bërë teknologjia digjitale për përditshmërinë e fëmijëve. Mediat sociale, lojërat dhe burimet në internet për detyrat e shtëpisë janë aktivitetet e tyre kryesore, me prirje të ndryshme ndërveprimi në varësi të moshës dhe gjinisë. Për shembull, u zbulua se djemtë ndërvepronin më shumë me lojërat dhe mediat sociale dhe një pjesë të madhe të ditës e kalonin me këto aktivitete. Ky ndërveprim kaq i shpeshtë, sidomos nga djemtë tregon se mund të ketë ekspozim ndaj ndikimeve si bullizmi kibernetik, varësitë ndaj lojërave në internet dhe pritshmëritë jorealiste në mediat sociale. Nga ana tjetër, vajzat ishin më të përqendruara në aktivitete në internet lidhur me detyrat e shkollës, ndonëse ka ende risqe si mbështetja e tepërt në burimet digjitale.

Gjithashtu, 40% e fëmijëve raportuan se e aksesojnë internetin përmes pajisjeve personale, si telefonat celularë, tabletat ose laptopët e tyre. Fakti që ata kanë pajisjet e tyre mund të shtojë pavarësinë e tyre në internet, por kjo gjë rrit ekspozimin ndaj risqeve në internet, pasi fëmijët mund të mos monitorohen aq shumë në pajisjet personale, sa do të monitoroheshin në pajisje të përdorura nga e gjithë familja. Ndonëse shumica e fëmijëve raportojnë se prindërit e tyre janë në dijeni të aktiviteteve të tyre në internet, 15% tregojnë se ka mbikëqyrje prindërore të kufizuar ose nuk ka aspak dhe, kjo shifër është më e lartë për fëmijët në zonat rurale. Mungesa e mbikëqyrjes së mjaftueshme në zonat rurale mund të paraqesë pabarazi për njohuritë digjitale të prindërve, duke theksuar nevojën për ndërhyrje. Kjo gjë tregon se ka nevojë për programe të përqendruara në aftësitë prindërore digjitale, për t'i ndihmuar prindërit me orientimin dhe monitorimin e ndërveprimeve të fëmijëve të tyre në internet, pavarësisht nga niveli i tyre i njohurive për teknologjinë digjitale.

Sa u përket aktiviteteve në internet, ndërveprimi i fëmijëve në mediat sociale, në lojëra dhe në platforma të tjera në internet është shtuar aq shumë sa pothuajse gjysma e tyre raportuan ndërveprime të përditshme me miqtë dhe të njohurit përmes këtyre kanaleve. Kjo ndërlidhje ka të mirat e sfidat e veta duke qenë se fëmijët po ekspozohen gjithnjë e më shumë ndaj informacioneve të ndryshme dhe ndikimeve nga bashkëmoshatarët, disa prej të cilave mund të mos jenë të përshtatshme për moshën e tyre. Për shembull, 8% e fëmijëve pohojnë se i pranojnë të gjitha kërkesat për miqësi në internet, gjë që përbën risqe të mëdha të lidhura me ekspozimin ndaj personave të panjohur. Fakti që fëmijët janë të hapur ndaj ndërveprimeve në internet, pavarësisht risqeve, thekson nevojën e ngutshme për edukimin rreth sjelljeve të sigurt në internet, që janë të përshtatshme për moshën dhe gjithëpërfshirëse për kontekstet specifike në internet të fëmijëve nga zonat urbane dhe nga zonat rurale.

4.2. NDËRGJEGJËSIMI I FËMIJËVE PËR SITUATAT E RREZIKSHME NË INTERNET

Pavarësisht këtyre boshllëqeve, fëmijët po përballen gjithnjë e më shumë me përmbajtje shqetësuese në internet. Përafërsisht 39% e të anketuarve thanë se kishin hasur në materiale që i kishte shqetësuar ose mërzhitur. Ekspozimi ndaj materialeve të tilla është i ndryshëm, por ato përfshijnë mesazhe të dëmshme, standarde jorealiste bukurie, referenca për vetëlëndimin dhe pamje të qarta me përmbajtje seksuale. Ky ekspozim mund të ndikojë ndjeshëm te shëndeti mendor, vetëbesimi dhe ndjenja e sigurisë në internet e fëmijëve. Vlen të theksohet që aftësitë e fëmijëve për t'i identifikuar dhe për t'i interpretuar këto rreziqe janë të ndryshme. Fëmijët më të vegjël ose ata që kanë më pak njohuri për risqet në internet ka gjasa ta nënvlerësojnë seriozitetin e situatave të caktuara. Këto gjetje vënë në dukje rëndësinë e krijimit të programeve gjithëpërfshirëse për njohuritë digjitale, që mund t'i fuqizojnë fëmijët për t'i njohur, aksesuar dhe trajtuar në mënyrë më efektive risqet në internet.

Shumica dërmuese e fëmijëve raportojnë se kanë ndaluar së shpërndari informacione të ndjeshme në internet, gjë që tregon se ka ndërgjegjësim të përgjithshëm për risqet e lidhura me privatësinë. Megjithatë, një përqindje më e vogël shqetësuese vazhdojnë të kenë sjellje të rrezikshme si pranimi i kërkesave për miqësi nga persona të panjohur, shpërndarja e detajeve personale ose keqprezantimi i moshës së tyre. Kjo sjellje vihet re më shumë te djemtë dhe fëmijët nga zonat rurale dhe tregon nevojën për një qasje më të përshtatur për edukimin rreth privatësisë. Edukimi i fëmijëve për pasojat e shpërndarjes së informacioneve personale dhe të ndërveprimit me persona të panjohur në internet mund të ndihmojë në zbutjen e këtyre risqeve. Ndërhyrje të tilla duhet të adresojnë edhe sjellje specifike të lidhura me menaxhimin e identitetit digjital, duke u ofruar fëmijëve mjete dhe udhëzime për lundrimin në mediat sociale, platformat e lojërave dhe platformave të tjera online me më shumë kujdes.

4.3. PËRGJIGJET E FËMIJËVE NDAJ SITUATAVE TË RREZIKSHME DHE NDËRGJEGJËSIMI PËR MEKANIZMAT E RAPORTIMIT

Përgjigjet e fëmijëve kur përballen me situata në internet, që mund të jenë të rrezikshme ose shqetësuese, janë të shumëllojshme dhe ndryshojnë në varësi të moshës, gjinisë dhe prejardhjes gjeografike. Shumë fëmijë priren të përgjigjen në mënyrë pasive, 43% zgjedhin ta injorojnë problematikën dhe 54% zgjedhin të mbyllin aplikacionin në fund të ndërveprimit. Këto lloje përgjigjesh tregojnë se shpesh fëmijët janë të pasigurt për mënyrën se si mund t'i trajtojnë ose t'i përballojnë situatat shqetësuese në internet. Pak fëmijë zgjedhin qasje proaktive si bllokimi i personit (56%), ose raportimi i incidentit (27%), pavarësisht se këto janë mjete efektive për zbutjen e problematikave të mëtejshme. Kjo prirje thekson nevojën për trajnimin e fëmijëve për t'i përdorur në mënyrë efektive këto veçori për përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj shqetësimeve në internet.

41% e fëmijëve raportuan ndjenja faji pasi kishin përjetuar ndërveprime shqetësuese në internet. Kjo tregon se disa fëmijë priren të brendësojnë fajin në situata që shpesh janë përtej kontrollit të tyre. Ky reagim emocional mund t'i pengojë fëmijët të kërkojnë ndihmë dhe mund t'i përkeqësojë ndjenjat e izolimit. Gjithashtu, fëmijët nga zonat rurale kanë më pak gjasa të kërkojnë ndihmë ose të përdorin mekanizmat formalë të sigurisë dhe, me shumë mundësi kjo ndodh për shkak të ekspozimit të kufizuar ndaj edukimit për sigurinë në internet. Në përgjigje të kësaj, duhet të krijohen fushata dhe burime ndërgjegjësimi për të theksuar se nuk është faji i fëmijëve që ata përballen me persona

ose përmbajtje shqetësuese në internet dhe, për t'i nxitur ata të flasin me të rritur të besuar ose të raportojnë incidentet.

Sa i përket rrjeteve të mbështetjes, bashkëmoshatarët janë personat më të besuar të fëmijëve dhe 33% e fëmijëve zgjedhin të flasin me miqtë për përvojat shqetësuese. Mbështetja te bashkëmoshatarët dhe jo te të rriturit, vë në dukje forcën dhe kufizimet e sistemeve të mbështetjes sociale të fëmijëve. Edhe pse mbështetja nga bashkëmoshatarët mund të jetë ngushëlluese, miqtë nuk kanë orientimet ose përvojën për të dhënë këshillat e duhura, veçanërisht për t'u përballur me risqet serioze në internet. Duke i nxitur fëmijët të flasin me të rritur të besuar, përfshirë prindërit, mësuesit ose këshilluesit, mund t'u ofrojmë atyre mbështetjen dhe ndërhyrjen e nevojshme për situatat e vështira.

Nga studimi u zbuluan boshllëqe të konsiderueshme lidhur me ndërgjegjësimin e fëmijëve për mjetet e sigurisë në internet, si funksionet e bllokimit dhe raportimit dhe qendrat e ndihmës. Pothuajse gjysma e fëmijëve të anketuar raportuan se nuk i njihnin ose nuk i kishin parë ndonjëherë këto veçori, madje fëmijët më të vegjël (veçanërisht 9-vjeçarët) kishin akoma më pak njohuri. Gjithashtu, u vërejtën dallime të shumta gjinore dhe gjeografike, pasi vajzat dhe fëmijët nga zonat rurale kishin më pak njohuri sesa bashkëmoshatarët e tyre rreth këtyre funksioneve të privatësisë. Kjo mungesë ndërgjegjësimi tregon se fëmijët ndërveprojnë në ambiente në internet pa pasur një njohje të mirë për mënyrën e menaxhimit të rreziqeve të mundshme, gjë që mund t'i ekspozojë ndaj përmbajtjeve ose ndërveprimeve të papërshtatshme.

Për ta përmbledhur, ky studim thekson nevojën e ngutshme për një qasje të shumanshme rreth njohurive digjitale dhe sigurisë së fëmijëve në internet. Palët e interesit mund t'i ndihmojnë fëmijët të lundrojnë më të sigurt në botën e internetit përmes edukimit të fëmijëve për sjelljet e sigurta në internet, rritjes së ndërgjegjësimit për mjetet e sigurisë në internet dhe zhvillimit të rrjeteve mbështetëse për raportimin dhe diskutimin e problematikave. Programet e përshtatura të edukimit për sigurinë digjitale, që synojnë grupe specifike në bazë të moshës, gjinisë dhe kontekstit gjeografik, do të jenë thelbësore për mbylljen e boshllëqeve lidhur me ndërgjegjësimin dhe veprimin. Edhe prindërit e mësuesit luajnë rol të rëndësishëm për përforcimin e praktikave të sigurta në internet dhe sigurimin se fëmijët ndihen të fuqizuar për të mbrojtur veten dhe për të kërkuar ndihmë kur u nevojitet.

5. REKOMANDIMET

Përfundimet e nxjerra nga studimi theksojnë nevojën për ndërhyrje të përshtatura dhe të shumanshme për mbrojtjen e përvojave të fëmijëve në internet. Këto ndërhyrje mund të grupohen në tre kategori:

5.1. NDËRHYRJE TË ORIENTUARA DREJT FËMIJËVE

- Këto ndërhyrje nevojitet të përqendrohen në krijimin dhe zbatimin e programeve të ndryshme për menaxhimin e përvojave në internet, që ndërthurin tematika të ndryshme ose ofrohen veç e veç, si pjesë e paketës së trajnimit të fëmijëve, përmes shkollave ose OJF-ve (Organizatave Jofitimprurëse), që bashkëpunojnë me shkollat ose qendrat komunitare:
 - programet gjithëpërfshirëse për njohuritë digjitale, me vëmendje të veçantë kushtuar fëmijëve në zonat rurale;
 - programet edukuese rreth sjelljeve të sigurta në internet, të përshtatura sipas moshës, kontekstit urban/rural në internet, për t'i ndihmuar fëmijët t'i njohin, aksesojnë dhe trajtojnë risqet në internet duke përdorur në mënyrë më efektive funksionin e bllokimit dhe raportimit dhe qendrat e ndihmës si përgjigje ndaj situatave shqetësuese në internet;
 - programet e trajnimit për t'i ndihmuar fëmijët të kërkojnë ndihmë, duke u përqendruar në nxitjen e tyre për të identifikuar dhe për t'u lidhur me të rritur të besueshëm për të menaxhuar përvojat e tyre në internet dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre.
- Nevojitet të organizohen edhe fushata ndërgjegjësimi me në fokus ndihmën ndaj fëmijëve për të folur me të rritur të besuar dhe për të raportuar ngjarje shqetësuese në internet, duke theksuar se fëmijët nuk janë fajtorë për këto situata dhe se kanë nevojë për mbështetje për të mbrojtur veten.

5.2. NDËRHYRJE TË ORIENTUARA DREJT PRINDËRVE

- Këto ndërhyrje mund të ndërthurin tematika të ndryshme ose të ofrohen veç e veç, si pjesë e paketës së trajnimit të prindërve (po njësoj, përmes shkollave ose OJF-ve përkatëse, që bashkëpunojnë me shkollat ose qendrat komunitare):
 - hartimin dhe zbatimin e programeve për aftësitë prindërore digjitale, me vëmendje të veçantë kushtuar prindërve në zonat rurale, për t'i ndihmuar ata me orientimin dhe monitorimin e ndërveprimeve të fëmijëve të tyre në internet;
 - hartimin dhe zbatimin e programeve të përqendruara në komunikimin me fëmijët, veçanërisht për tema delikate, për të ndërtuar ura komunikimi, ku prindërit mund

të shtojnë ndërveprimin e tyre aktiv lidhur me aktivitetet në internet dhe fëmijët mund të flasin me prindërit e tyre për tema delikate si: seksualiteti, bullizmi, bllokimi i ndërveprimeve shqetësuese etj.

5.3. NDËRHYRJE TË ORIENTUARA DREJT SHKOLLAVE


- Logjikisht, shkollat janë vendi i duhur për shumicën e ndërhyrjeve të mësipërme duke qenë se fëmijët e kalojnë shumicën e kohës së tyre atje, me grupet e bashkëmoshatarëve të tyre dhe mund të mbështesin njëri-tjetrin për menaxhimin e përvojave në internet. Gjithashtu, prindërit mund të kontaktohen më lehtë dhe të mbështesin njëri-tjetrin për mbrojtjen e fëmijëve të tyre (që janë në të njëjtën klasë). Krahaskëtyre, stafipërkatësi shkollave, kryesisht punonjësit socialë dhe psikologët, që janë pjesë e shërbimeve psiko-sociale të shkollave, por edhe mësuesit kujdestarë dhe mësuesit që koordinojnë aktivitetet e nxënësve, përfshirë qeveritë e nxënësve, duhet të trajnohen përmes:
 - hartimit dhe zbatimit të programeve për aftësitë digjitale, për t'u përgjigjur ndaj nevojave të fëmijëve për mbështetje me menaxhimin e përvojave të tyre në internet;
 - hartimit dhe zbatimit të programeve për ndërtimin dhe përmirësimin e komunikimit mes prindërve dhe fëmijëve për të lundruar sa më mirë në botën e internetit, përmes maksimizimit të aspekteve pozitive dhe minimizimit të risqeve.

6. REFERENCAT

- Komisioni Broadband për Zhvillim të Qëndrueshëm (2019). Child Online Safety: Minimizing the Risk of Violence, Abuse and Exploitation Online [Siguria e fëmijëve në internet: Minimizimi i rrezikut të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit në internet]. Tetor 2019. I disponueshëm në https://www.broadbandcommission.org/Documents/working-groups/ChildOnlineSafety_Report.pdf
- <https://www.crca.al/en/albanian-authorities-unprepared-to-protect-children-in-cyberspace/>
- Instituti i DQ-së (2023). Global Standards for Digital Development [Standardet Globale për Zhvillimin Digjital]. I disponueshëm në <https://www.dqinstitute.org/>
- Dunja A, Gjergji O, Gvineria D, Hallkaj E, and Verzivolli I. 2019 One Click Away: Children's Experience of Internet Use in Albania. [Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri]. UNICEF në Shqipëri & IPSOS Strategic Marketing, Tiranë. I disponueshëm në <https://www.unicef.org/albania/media/4346/file/One%20Click.pdf>
- Guerra, C., & Pereda, N. (2015). Research with adolescent victims of child sexual abuse: Evaluation of emotional impact on participants [Studimi me adoleshentët viktimë të abuzimit seksual me fëmijë: Vlerësimi i ndikimit emocional te pjesëmarrësit]. Journal of Child Sexual Abuse [Revista e Abuzimit seksual të fëmijëve], 24 (8), 943-58.
- INHOPE (2023). Raporti vjetor për vitin 2023. I disponueshëm në <https://inhope.org/media/pages/articles/annual-reports/6a4f5f6bd2-1710410986/inhope-annual-report-2023.pdf>
- <http://globalkidsonline.net/results/>
- Priebe, G., Backstrom, M., & Ainsaar, M. (2010). Vulnerable adolescent participants' experience in surveys on sexuality and sexual abuse: Ethical aspects [Përvoja e pjesëmarrësve adoleshentë të cenueshëm në anketat rreth seksualitetit dhe abuzimit seksual: Aspektet etike]. Child Abuse & Neglect [Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve]: The International Journal, 34 (6), 438-47.
- Republika e Shqipërisë. (2017). Kodi Penal, i disponueshëm në: <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=11&catid=10&m=0>
- Republika e Shqipërisë. (2017). Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i disponueshëm në: <https://www.unicef.org/albania/media/2596/file/KODI%20-%20botimi%20dhjetor%202019.pdf>
- Republika e Shqipërisë. (2017). Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", i disponueshëm në: <https://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2017/06/Law-No-18-2017-On-the-rights-and-protection-of-the-child.pdf>
- Barbovski, M., Green, L., & Vandoninck, S. (2013). Innovative approaches for investigating how children understand risk in new media: dealing with methodological and ethical challenges [Qasjet novatore për hetimin e mënyrës se si fëmijët kuptojnë rrezikun në median e re: trajtimi i sfidave metodologjike dhe etike]. Londër: EU Kids Online, LSE.
- World Vision. 2014. Studim mbi Sigurinë e Fëmijëve Online në Shqipëri. I disponueshëm në: <https://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>
- UNICEF (23 qershor 2022). Protecting children online [Mbrojtja e fëmijëve në internet]. I disponueshëm në <https://www.unicef.org/protection/violence-against-children-online>
- UNICEF, Faktori Web: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri. (2019)



CHILD SEXUAL
ABUSE PREVENTION
AND EDUCATION



Save the Children



**Financuar nga
Bashkimi European**

Financuar nga Bashkimi European.
Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura
janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht ato të Bashkimit
Evropian ose Komisionit Evropian. As
Bashkimi Evropian dhe as autoriteti finansues
nuk mbajnë përgjegjësi për to.